

LIGJI Nr. 05/L -045

PËR SIGURIMET

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

LIGJ PËR SIGURIMET

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është që të përcaktojë parimet dhe rregullat themelore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve, risiguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera të parapara me këtë ligj, në mënyrë që industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës të operojë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe transparente, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të policëmbajtësve.

2. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën lidhur me ushtrimin dhe ndjekjen e biznesit të sigurimeve dhe risigurimeve (Direktiva 2009/138/EC) dhe Direktivën për ndërmjetësimin e sigurimit (Direktiva 2002/92/EC).

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat juridik dhe fizik, që ushtrojnë veprimtari të sigurimeve, risigurimeve, ndërmjetësimin në sigurime si dhe subjekteve tjera që ushtrojnë aktivitete që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Me këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1. **Menaxhimi i rrezikut** - nënkupton tërësinë e metodave dhe të rregullave, që përdoren nga siguruesit/risiguruesit për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mundshme, me qëllim të shmangies së humbjeve financiare;

1.2. **Aksionari kryesor** - nënkupton posedimin direkt apo indirekt në një subjekt, i cili përfaqëson dhjetë përqind (10%) ose më shumë të aksioneve, me të drejtë vote;

1.3. **Drejtor** - nënkupton çdo person, i emëruar nga aksionarët për të shërbyer si anëtar

i bordit të drejtorëve të siguruesit apo ndërmjetësuesit në sigurime;

1.4. **Aktuari** - nënkupton personin, i cili ka për detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, provizioneve teknike dhe matematike, duke u mbështetur në metodat aktuaristike;

1.5. **Anuiteti** - nënkupton kontratë sigurimi nga e cila përfitohen të ardhura periodike, e cila mund të jetë për një numër të caktuar vitesh ose për gjithë jetën;

1.6. **BQK** - nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;

1.7. **Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës** - nënkupton autoritetin mbikëqyrës të vendit të jashtëm, i autorizuar sipas legjislacionit përkatës, të ushtrojë mbikëqyrjen e siguruesve, risiguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime;

1.8. **Bashkësigurimi** - nënkupton shërbimin e ofruar nga më shumë se një sigurues, me anë të një kontrate të vetme për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga rreziqet e specifikuar në kontratë, për një prim të përgjithshëm ose që ofron përfitime sipas kushteve të kontratës, në masën e paracaktuar, si dhe krijimin dhe menaxhimin e provizioneve nga çdo sigurues në përputhje me pjesën e tyre përkatëse të detyrimit;

1.9. **Cedim** - nënkupton kalimin e një pjese të rrezikut të siguruar nga një sigurues te një risigurues;

1.10. **Delegim** - nënkupton transferimin, e një ose disa funksioneve të veprimtarisë së siguruesit te një person tjetër, funksione të cilat në rast të mosdelegimit kryhen nga vetë siguruesi;

1.11. **Dëmshpërblimi i sigurimit** - nënkupton shumën, për të cilën siguruesi i detyrohet të siguroarit, përfituesit, ose ndonjë pale tjetër të dëmtuar, e cila rrjedh si e drejtë nga një kontratë e sigurimit;

1.12. **Menaxher i lartë** - nënkupton kryeshefin ekzekutiv, zyrtarin kryesor për financa, zyrtarin kryesor të marrjes në sigurim, zyrtarin kryesor të dëmeve dhe çdo person tjetër që:

1.12.1. i raporton drejtpërsëdrejti bordit të drejtorëve ose merr pjesë ose ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të siguruesit, ndërmjetësuesit apo subjekteve tjera të licencuara sipas këtij ligji;

1.12.2. është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja;

1.12.3. në rastin e siguruesit të jashtëm të licencuar në Kosovë, menaxheri kryesor, zyrtari kryesor i marrjes në sigurim, zyrtari kryesor i dëmeve dhe zyrtari kryesor financiar, konsiderohet anëtar i menaxhmentit të lartë.

1.13. Personat ose palët e ndërlidhura me siguruesit ose ndërmjetësuesit sipas këtij ligji konsiderohen personat në vijim:

1.13.1. Menaxherët e lartë, anëtarët e bordit të drejtorëve dhe aksionarët

kryesorë të siguruesit ose ndërmjetësuesit; personat e afërt me menaxherët e lartë me anëtarët e bordit të drejtorëve apo me aksionarët kryesorë të siguruesit ose ndërmjetësuesit, që lidhen me martesë ose afërsi të gjakut deri në shkallën e dytë;

1.13.2. Personat juridikë në të cilët menaxherët e lartë, anëtarët e bordit të drejtorëve apo aksionarët kryesorë të siguruesit ose ndërmjetësuesit janë po ashtu aksionarë kryesorë;

1.13.3. Personat që kanë interes të konsiderueshëm në personin juridik ku siguruesi ose ndërmjetësuesi ka interes të konsiderueshëm;

1.13.4. Filialet (subjektet e varura) siguruesit apo ndërmjetësuesit të sigurimeve.

1.14. **Grup** - nënkupton një grup biznesor, i përbërë nga kompania amë, kompanitë e kontrolluara prej saj, si dhe të gjitha subjektet, mbi të cilat kompania amë apo kompania e kontrolluar prej saj ushtron ndikim të rëndësishëm apo zotëron interes të konsiderueshëm;

1.15. **Anëtar joekzekutiv** - nënkupton anëtarët e bordit të drejtorëve, të cilët nuk janë punonjës të siguruesit apo ndërmjetësuesit dhe nuk janë të përfshirë në menaxhimin operacional të tyre;

1.16. **Klasë e sigurimit** - nënkupton klasifikimin e një grupi të ngjashëm të produkteve dhe rreziqeve ose operacioneve, që përcaktojnë veprimtarinë e siguruesit sipas licencës së lëshuar nga BQK-ja;

1.17. **Klient** - nënkupton çdo person që përdor ose përfiton shërbimet e ofruara nga siguruesi ose nga ndërmjetësuesi;

1.18. **Ngjarje e siguruar** - nënkupton ngjarjen e parashikuar në kontratën e sigurimit, që ndodh brenda kushteve dhe periudhës së mbuluar nga sigurimi;

1.19. **Periudha e mbulimit nga sigurimi** - nënkupton periudhën, për të cilën një sigurues mbulon rrezikun e siguruar;

1.20. **Person** - nënkupton personin fizik dhe juridik;

1.21. **Përfituesi** - nënkupton personin në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit apo që përfiton nga kjo e fundit;

1.22. **Interes i konsiderueshëm** - nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kapitalit, aksioneve ose të drejtave tjera të një personi juridik, në bazë të të cilave personi zotëron pesë për qind (5%) ose më shumë të së drejtës së votës ose të kapitalit të një personi juridik;

1.23. **Portofol i sigurimit** - nënkupton tërësinë e kontratave të sigurimit të një klase ose disa klasave të sigurimit, të nënshkruara nga një sigurues;

1.24. **Produkt i sigurimit** - nënkupton kontratën (polica) specifike të përgatitur dhe të

lëshuar nga siguruesi, për të mbuluar një rrezik specifik ose një numër të veçantë të rreziqeve sipas kushteve të përcaktuara;

1.25. **Provizione teknike** - nënkupton shumën e përcaktuar në bazë të metodave aktuaristike, të cilat mbahen nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jo-jetës;

1.26. **Provizione matematike** - nënkupton shumën e përcaktuar në bazë të metodave aktuaristike, të cilat mbahen nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës;

1.27. **Sigurim** - nënkupton transferimin e një rreziku të mundshëm, të një humbjeje pasurore dhe/ose jopasurore nga i siguruari te siguruesi, sipas një kontrate sigurimi;

1.28. **Risigurim** - nënkupton cedimin e rreziqeve të caktuara nga një sigurues te një risigurues;

1.29. **Sigurim i jetës** - nënkupton sigurimin e rrezikut sipas klasave të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji;

1.30. **Sigurim i jo-jetës** - nënkupton sigurimin e rrezikut sipas klasave të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji;

1.31. **I siguruar** - nënkupton personin, humbja e mundshme pasurore dhe/ose jopasurore e të cilit është objekt i një kontrate sigurimi. Në kontratat e sigurimit të jetës, i siguruari është person fizik, jeta e të cilit është siguruar;

1.32. **Sigurues** - nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimeve sipas përcaktimeve të këtij ligji;

1.33. **Siguruesit e jashtëm** - nënkupton degën e siguruesit të jashtëm, e cila ka selinë kryesore në ndonjë vend të jashtëm dhe është licencuar për të ushtruar aktivitet sigurues në Republikën e Kosovës;

1.34. **Subjekt i varur** - nënkupton personin juridik të veçantë i themeluar nga siguruesi ose personi juridik, që është nën kontroll të përbashkët me siguruesin;

1.35. **Risigurues** - nënkupton personin juridik, i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi sipas përcaktimeve të këtij ligji;

1.36. **Shuma e sigurimit (limiti i përgjegjësisë)** - nënkupton vlerën, për të cilën janë pajtuar siguruesi dhe i siguruari apo që mund të jetë përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi dhe që përcakton kufirin e përgjegjësisë së siguruesit kundrejt të siguruarit;

1.37. **Veprimtari e sigurimit** - nënkupton përgatitjen, ofrimin, nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave të sigurimit të jetës dhe jo-jetës nga siguruesit;

1.38. **Veprimtari e risigurimit** - nënkupton nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave të risigurimit, për kalimin të një pjese apo gjithë rrezikut të marrë përsipër, nëpërmjet

kontratës së sigurimit, nga siguruesi në një risigurues;

1.39. Për qëllime të këtij ligji, “**masat e riorganizimit**” nënkuptojnë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe rivendosjen e shëndetit financiar të siguruesve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;

1.40. **Bond (obligacion)** - është investim borxhi, në të cilin një investitor i jep hua të holla një njësie ekonomike, në mënyrë tipike Korporatave apo Qeverisë, e cila huazon fonde për një periudhë të caktuar kohore, me një normë variable apo fikse të interesit;

1.41. **Mbikëqyrja në vend apo on site** - është testimi dhe verifikimi i të dhënave të ofruara nga institucioni;

1.42. **Mbikëqyrja nga jashtë apo off site** - është një proces i vazhdueshëm i cili përfshin analiza periodike të informatave të dorëzuara nga siguruesit dhe ngjarjeve të tjera, që mund të ndikojnë në gjendjen e përgjithshme të një institucioni.

2. Për qëllime të këtij ligji, përveçse kur është specifikuar ndryshe me dispozita të veçanta, me termat:

2.1. **Sigurues** - kuptohet “sigurues dhe/ose risigurues”;

2.2. “**Ndërmjetësues në sigurime**” kuptohet “ndërmjetësim në sigurime dhe/ose risigurime dhe trajtues të dëmeve”;

2.3. **Provizione teknike** - kuptohet “provizione teknike dhe/ose matematike”.

Neni 4

Përgjegjësitë e BQK-së

1. Përgjegjësitë kryesore të BQK-së sipas këtij ligji janë:

1.1. të sigurojë mbrojtjen e interesave të policëmbajtësve, të dëmtuarve, si dhe t'i mbajë të informuar në lidhje me sigurimet;

1.2. të sigurojë ligjshmërinë, efikasitetin, stabilitetin, likuiditetin dhe aftësinë paguese të siguruesve, dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve, si dhe të subjekteve tjera të përcaktuara me këtë ligj;

1.3. të sigurojë një konkurrencë të drejtë dhe të rregullt, duke inkurajuar në këtë mënyrë zhvillimin, shtrirjen e produkteve dhe shërbimeve të sigurimit në dobi të mirëqenies publike, si dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për investitorët potencialë në industrinë e sigurimeve në Kosovë.

2. BQK-ja sipas këtij ligji ka përgjegjësinë ekskluzive për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, si dhe të subjekteve tjera që ushtrojnë aktivitetet e parashikuara me këtë ligj.

3. BQK-ja e ka përgjegjësinë ekskluzive për caktimin e standardeve dhe nxjerrjen e rregulloreve,

urdhëresave dhe udhëzimeve, lidhur me sjelljen e sigurve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera që ushtrojnë aktivitetet e parashikuara me këtë ligj. Rregulloret, urdhëresat dhe udhëzimet e tilla do të publikohen dhe do të hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 5 **Ndalesat dhe përjashtimet**

1. Asnjë person nuk mund të merret me veprimtari të sigurimeve, risigurimeve, ndërmjetësimit të sigurimeve apo veprimtari tjera, që kërkohet të licencohen dhe aprovohen me këtë ligj, pa licencë dhe aprovim të vlefshëm të lëshuar nga BQK-ja sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Asnjë person nuk mund të përdorë fjalën “sigurim”, “risigurim”, “ndërmjetësues në sigurime” “trajtues i dëmeve” ose derivatet e këtyre fjalëve në lidhje me një veprimtari, produkt ose shërbim ose në veprimtari promociionale pa pasur një licencë të lëshuar nga BQK-ja, për t’u përfshirë në aktivitetin e sigurimeve, përveç kur një përdorim i tillë është vendosur ose njohur me këtë ligj. Asnjë zyre përfaqësuese nuk mund të përdorë fjalën “sigurim” në emrat e tyre, përveç rasteve kur fjala “sigurim” formon një pjesë integrale të emrit të sigurve të jashtëm të cilit ato i përkasin me kusht që, në raste të tilla të shtohet fjala “zyra përfaqësuese”.

3. Asnjë sigurve, risigurve, ndërmjetësues i sigurimit apo trajtues i dëmeve nuk mund të përdorë në emrin e vet fjalë, që mund të çojnë në keqpërdorime lidhur me kushtet e tyre financiare, statusin ligjor ose lidhjen me Qeverinë apo me institucionet ndërkombëtare.

4. Sigurve i një vendi të jashtëm nuk lejohet të ofrojë dhe të marrë në sigurim të drejtpërdrejtë një rrezik, që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie, që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa u licencuar nga BQK-ja.

5. Dispozita e paragrafit 4. të këtij neni nuk zbatohet për sigurimin e rreziqeve të lidhura me transportin detar dhe ajror, sigurimin e personit jorezident në Republikën e Kosovës apo kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Kosovës është palë. Por në raste të veçanta mund të kërkohet aprovimi nga BQK-ja.

6. Asnjë person nuk mund të bëjë deklarime të pavërteta për fakte materiale ose të bëjë një paraqitje të rreme ose çorientuese, të fshehtë apo të bëjë çdo gjë për të krijuar një pamje të rreme ose mashtruese, për lëshimin policave të sigurimit.

7. Sigurve i licencuar për angazhim në çdo lloj të sigurimit të jo-jetës, nuk duhet të ofrojë sigurimin e jetës dhe anasjelltas.

8. Veprimtaria e risigurimit ushtrohet nga risigurve i licencuar nga BQK-ja dhe ushtron vetëm veprimtari risigurimi.

9. Risigurve mund të ushtrojë veprimtari risigurimi njëkohësisht për klasat e sigurimit të jetës dhe jo-jetës.

10. BQK-ja mund të lejojë që sigurve të licencuar në Kosovë, t’i sigurojnë rreziqet e veta të një risigurve i vendit të jashtëm, pavarësisht faktit nëse këta risigurve nuk janë të licencuar në Kosovë.

Neni 6**Fushëveprimi dhe kufizimi i licencës së Siguruesit**

1. Licenca për veprimtarinë e sigurimit të jo-jetës, jepet për klasa të veçanta, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.
2. Licenca për veprimtarinë e sigurimit të jetës jepet veçmas ose për të gjitha klasat e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.
3. Licenca për veprimtarinë e risigurimit, jepet për të gjitha klasat e veprimtarisë së sigurimit.
4. Licenca e lëshuar nga BQK-ja është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.
5. BQK-ja mund të lejojë që një sigurues i licencuar për të mbuluar një rrezik kryesor, që i përket një apo disa klasave të sigurimit jo-jetë, të mund të ofrojë sigurim edhe për rreziqe ndihmëse nga klasat tjera të sigurimit jo-jetë, për të cilat nuk është licencuar. BQK-ja me rregullore përcakton kushtet kur një rrezik i caktuar konsiderohet rrezik ndihmës në raport me rrezikun kryesor brenda klasëve të sigurimit jo-jetë.

**NËNKAPITULLI I
KLASAT E SIGURIMIT****Neni 7****Veprimtaria e sigurimit të jo jetës**

1. Sigurimi i aksidenteve, përfshirë lëndimet industriale dhe sëmundjet e profesionit, mbulon:
 - 1.1. përftimin e menjëhershëm të plotë të një shume të caktuar monetare;
 - 1.2. përftim me natyrë rimbursimi (pagesa e shumës së sigurimit me këste);
 - 1.3. përftimin e kombinuar, të paraparë në paragrafin 1, nënparagrafin 1.1 dhe nënparagrafin 1.2. të këtij neni;
 - 1.4. përftimin ndaj lëndimeve, çrregullimeve shëndetësore ose vdekjes së pasagjerëve.
2. Sigurimi i shëndetit mbulon:
 - 2.1. të ardhura fikse financiare nga paaftësia shëndetësore;
 - 2.2. përfitime me natyrë rimbursimi;
 - 2.3. përftimin e kombinuar, të paraparë në paragrafin 2, nënparagrafin 2.1 dhe nënparagrafin 2.2. të këtij neni.
3. Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina) mbulon dëmtimet ose humbjet nga:

- 3.1. mjetet tokësore motorike;
- 3.2. mjetet tokësore jomotorike.
4. Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina.
5. Sigurimi i avionëve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuar nga mjetet ajrore.
6. Sigurimi i anijeve mbulon dëmtimet ose humbjet e pësuar nga:
 - 6.1. anijet lumore dhe të kanaleve;
 - 6.2. anijet e liqeneve;
 - 6.3. anijet detare.
7. Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve) mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë transportit ose bagazhet, pavarësisht nga mënyra e transportit.
8. Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës mbulon dëmtimin ose humbjen e sendeve të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7, të parapara në paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni, të shkaktuara nga:
 - 8.1. zjarret;
 - 8.2. shpërthimet;
 - 8.3. stuhitë;
 - 8.4. forcat e natyrës të ndryshme nga stuhia;
 - 8.5. energjia nukleare;
 - 8.6. rrëshqitja e tokës dhe tërmeti.
9. Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë mbulon të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri, të ndryshme nga ato që përfshihen në klasat 3, 4, 5, 6 dhe 7 të parapara në paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni, kur dëmi është shkaktuar nga breshëri, përmytjet ose nga ngrica dhe çdo ngjarje e tillë, si vjedhje të ndryshme nga ato të përmendura në klasën 8 të paraparë në paragrafin 8 të këtij neni.
10. Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve mbulon të gjitha përgjegjësitë, që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit dhe mbulimin e përgjegjësive të detyrueshme).
11. Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i avionëve mbulon të gjitha përgjegjësitë, që lindin

nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

12. Sigurimi i përgjegjësive për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë, që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

13. Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme mbulon të gjitha përgjegjësitë, përveç atyre të përmendura në klasat 10, 11 dhe 12 të parapara në paragrafët 10, 11 dhe 12 të këtij neni.

14. Sigurimi i kredive mbulon:

14.1. rrezikun e mos pagesës për shkak të paaftësisë paguese;

14.2. kreditë e eksportit dhe rreziqe të tjera, që shoqërohen me eksportin;

14.3. kreditë lidhur me tregtinë dhe investimet brenda dhe jashtë vendit;

14.4. kreditë e shlyera me këste;

14.5. kreditë hipotekare;

14.6. kreditë bujqësore;

14.7. kredi të tjera.

15. Sigurimi i garancioneve mbulon:

15.1. garancionet e drejtpërdrejta;

15.2. garancionet e tërthorta (jo të drejtpërdrejta);

15.3. Bondet.

16. Sigurimi i humbjeve të ndryshme financiare, mbulon humbjet financiare të shkaktuara si pasojë e:

16.1. rrezikut në punësim;

16.2. pamjaftueshmërisë së të ardhurave për çfarëdo arsye;

16.3. motit të keq;

16.4. humbjes së të ardhurave;

16.5. shpenzime të përgjithshme të vazhdueshme dhe shpenzime të tjera;

16.6. shpenzimeve tregtare dhe operacionale të paparashikuara;

16.7. humbjes së vlerës në treg;

16.8. humbjes nga qiratë ose të ardhurat;

16.9. humbjes indirekte nga tregtimi, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër;

16.10. humbjeve financiare, të tjera nga ato tregtare;

16.11. llojeve të tjera të humbjeve financiare.

17. Sigurimi i mbrojtjes ligjore mbulon:

17.1. shpenzimet për shërbimet ligjore dhe ato gjyqësore, si dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësore.

18. Sigurimi i Asistencës mbulon:

18.1. ndihmën për personat që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve ose në raste të tjera të largësisë nga shtëpia ose vendbanimi i përhershëm.

Neni 8

Veprimtaria e sigurimit të jetës

1. Sigurimi i jetës mbulon:

1.1. sigurimin për vdekjen;

1.2. sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;

1.3. sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;

1.4. sigurimin e jetës me kthim të primeve.

2. Sigurimi i martesës - lindjes mbulon:

2.1. shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;

2.2. përfundimi i kushteve të sigurimit, e cila ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.

3. Sigurimi i jetës i lidhur me ndërmarrjet e investimeve kolektive mbulon:

3.1. sigurimin e jetës në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të ndërmarrjeve të investimeve kolektive ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.

4. Anuitetet mbulojnë:

4.1. sigurimin e jetës me elemente kursimi;

4.2. sigurimin e jetës me afat të përcaktuar;

4.3. anuitete të shtyra;

4.4. anuitete të menjëhershme.

5. Sigurimi shtesë i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

5.1. vdekje si rezultat i aksidentit;

5.2. paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;

5.3. paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;

5.4. paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;

5.5. paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;

5.6. paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;

5.7. shërbimet spitalore;

5.8. sëmundjet e pashërueshme;

5.9. shërbimet mjekësore.

6. Veprimtaria e sigurimit të jetës gjithashtu përfshin edhe operacionet e mëposhtme në sigurime:

6.1. sigurimi i individëve të bashkuar për qëllime të kapitalizimit të kontributeve të tyre dhe shpërndarjes së aktiveve në raport me fondet e akumuluar midis personave që kanë arritur një moshë të caktuar (të mbijetuarve) ose midis përfituesve të sigurimit në rast vdekjeje të personave të siguruar;

6.2. kthimi i kapitalit i cili është një lloj sigurimi për një periudhë të caktuar, ku siguruesi në këmbim të primeve, bie dakord në pagesën e një shume të caktuar në përfundim të periudhës së rënë dakord;

6.3. administrimi i investimeve të fondeve të pensioneve dhe në veçanti të aktiveve, të cilat përfaqësojnë rezervat e subjekteve, të cilat kanë ndikim mbi pagesat në rast vdekjeje apo mbijetese apo në rast të mosvazhdimet ose përfundimit të veprimtarisë.

Neni 9

Sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia

1. Veprimtaria e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe sigurimet tjera të detyrueshme rregullohen me ligje të veçanta.
2. BQK-ja mund të nxjerr rregullore, me të cilën përcaktohen kriteret e vlerësimit të dëmeve jo materiale.

KAPITULLI II

LICENCIMI I SIGURUESVE

Neni 10

Kërkesat per licencë

1. Kërkesat për licencë për të themeluar dhe operuar me një sigurues ose një degë të siguruesit të jashtëm, duhet të jenë në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe shoqërohen nga informacionet dhe dokumentacionet e mëposhtme:

1.1. kopjen e noterizuar të aktit të themelimit dhe statutin, si dhe adresën e selisë qendrore në Republikën e Kosovës;

1.2. lista e aksionarëve, lloji i aksioneve, të dhëna për vlerën nominale të aksioneve, përqindja e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar dhe personat apo palët e mundshme të ndërlidhura;

1.3. të dhënat personale, kualifikimet dhe përvojën e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguruesit të propozuar, duke përfshirë historikun afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit, ndërsa për degë të siguruesit të jashtëm kërkesa e tillë aplikohet vetëm për menaxherët e lartë;

1.4. shumën e kapitalit të autorizuar dhe të zotuar të siguruesit të propozuar ose të degës së siguruesit të jashtëm, duke përfshirë shumat të cilat janë paguar dhe burimin e ligjshëm të kapitalit;

1.5. planin e biznesit që përfshin, ndër të tjera, strukturën organizative të siguruesit të propozuar ose të degës së siguruesit të jashtëm; produktet, primet dhe llogaritjet e tyre; funksionimi i auditimit të brendshëm; funksionimi i menaxhimit të rrezikut; sistemet e kontroleve të brendshme; sistemet e teknologjisë informative; llojin e parashikuar të veprimtarive të sigurimeve; pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite dhe, pasqyrat financiare të audituara dhe raportet vjetore për tri (3) vitet e fundit, nëse ekzistojnë;

1.6. të dhënat personale, historikun afarist dhe profesional për dhjetë vitet e fundit dhe pasqyrat financiare të audituara për tri (3) vitet e fundit (nëse ekzistojnë) të çdo aksionari kryesor të siguruesit të propozuar;

1.7. për çdo drejtor ose menaxher të lartë apo aksionar kryesor të siguruesit të propozuar ose të degës së siguruesit të jashtëm, dëshminë zyrtare nga Gjykata që

shpalos çdo dënim për vepra penale, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka;

1.8. draft-kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licençohet;

1.9. plan-programi për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

1.10. në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një sigures i jashtëm, që propozon themelimin e një kompanie varëse të sigurimeve ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të aktiviteteve të propozuara në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje të konsoliduar të veprimtarisë ndaj siguresit të jashtëm përfshirë kompaninë varëse të sigurimeve apo degën e siguresit të jashtëm, që kërkon të licençohet në Kosovë;

1.11. informacione tjera shtesë të cilat mund të kërkojnë nga BQK-ja.

Neni 11

Miratimi paraprak

1. Brenda tre (3) muajve nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë, BQK-ja paraprakisht miraton ose refuzon atë dhe njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës për vendimin e saj. Njoftimi për refuzim të licencës duhet të cekë arsyet mbi bazë të së cilave është refuzuar licenca.

2. BQK-ja do të refuzojë një kërkesë për licencë, nëse nuk përmbushen kriteret e përcaktuara me këtë ligj, nëse aplikuesi qëllimisht ka ofruar dokumentacion të falsifikuar dhe nëse gjykon se lëshimi i një licence të tillë do të:

2.1. vinte në rrezik qëndrueshmërinë financiare të siguresit të propozuar ose të industrisë së sigurimeve në përgjithësi;

2.2. rrezikonte interesat e policëmbajtesve të siguresit të propozuar, apo;

3. BQK-ja paraprakisht miraton një kërkesë për licencë vetëm nëse i plotësohen kushtet e mëposhtme:

3.1. nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;

3.2. struktura organizative e siguresit të propozuar dhe degëve të tij do t'i lejojë BQK-së të ushtrijë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;

3.3. primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguresit;

3.4. siguresi i propozuar do të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e këtij ligji;

3.5. kualifikimet, përvoja dhe integriteti i drejtorëve apo menaxherëve të saj të lartë janë të përshtatshëm për planin e biznesit të siguruesit të propozuar dhe aktiviteteve të sigurimit;

3.6. aksionarët kryesorë, drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesit të propozuar janë të përshtatshëm dhe të duhur, siç përcaktohet me nenin 24 të këtij ligji dhe përcaktimeve tjera nga BQK-ja, dhe;

3.7. struktura e pronësisë së siguruesit, nuk do të pengoj mbikëqyrjen efektive prej BQK-së.

4. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, miratimi paraprak i kërkesës për licencë lidhur me një subjekt të varur ose degë të siguruesit të jashtëm bëhet vetëm nëse:

4.1. siguruesi i jashtëm është i licencuar për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në juridiksionin ku gjendet drejtoria e saj qendrore;

4.2. autoriteti mbikëqyrës përgjegjës ku ka selinë qendrore siguruesi i jashtëm, ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për dhënien e licencës së këtillë, dhe;

4.3. BQK-ja vlerëson se siguruesi i jashtëm mbikëqyrjet në mënyrë adekuate në bazë të konsoliduar nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës në shtetin amë. Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës nga shteti amë, duhet ta pranojë me shkrim se është në dijeni të dhënies së licencës së re dhe pajtohet që t'i ofrojë informata BQK-së me kërkesë të saj.

5. Në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë, BQK-ja përcakton të gjitha kushtet që duhet t'i plotësoj siguruesi, para se t'i ipet licenca për fillimin e operacioneve të saj.

Kushtet e tilla janë si në vijim:

5.1. pagesën e kapitalit fillestar që aksionarët duhet të bëjnë për siguruesin;

5.2. punësimin dhe trajnimin e personelit të siguruesit;

5.3. blerjen e pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative, si dhe funksionalizimin e tyre;

5.4. marrjen me qira, blerjen ose zotërimin e lokaleve të siguruesit;

5.5. primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike janë të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të siguruesit;

5.6. draft-kontratat e sigurimit sipas klasave ku siguruesi kërkon të licencohet;

5.7. angazhimin e një auditori të jashtëm dhe aktuari në përputhje me këtë ligj;

5.8. çdo kusht tjetër që BQK-ja e konsideron të përshtatshëm.

6. Nëse brenda një (1) viti siguruesi nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, miratimi paraprak i kërkesës do të revokohet.

Neni 12

Dhënia e licencës

1. Nëse BQK-ja vlerëson se janë plotësuar kushtet e licencimit sipas këtij ligji, do ta japë licencën.
2. Licenca jepet me shkrim, në pajtim me nenin 6 të këtij ligji.

Neni 13

Lejet për zyrat përfaqësuese

1. Asnjë sigurues i jashtëm nuk mund të themelojë dhe operojë me një zyrë përfaqësuese në Kosovë pa leje paraprake nga BQK-ja.
2. BQK-ja mund të japë leje për një zyre përfaqësuese në Kosovë, me kusht që të sigurohet se siguruesi i jashtëm do t'i kufizojë aktivitetet e saja të zyrës përfaqësuese në ofrimin e informatave dhe aktiviteteve ndërlidhëse dhe studimit të tregjeve dhe mundësive për investim, dhe se siguruesi i jashtëm nuk do të angazhohet në aktivitet të sigurimit në Kosovë nëpërmjet zyrës përfaqësuese.
3. Kërkesat nga një sigurues i jashtëm për leje për të themeluar dhe operuar me një zyre përfaqësuese, duhet të bëhen në mënyrën e përcaktuar me rregullore nga BQK-ja dhe do të shoqërohet me informatat e kërkuara nga BQK-ja.

Neni 14

Degët dhe zyrat shtesë

1. Një sigurues duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja para se të themelojë, zhvendosë ose mbyllë një degë ose zyrë në Kosovë.
2. Siguruesi, me përjashtim të degës së siguruesit të jashtëm, duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja para se të themelojë ose hapë një degë në ndonjë juridiksion tjetër.
3. BQK-ja përcakton me rregullore procedurën për marrjen e miratimit paraprak me shkrim dhe formën e përmbajtjen e kërkesës.

Neni 15

Shndërrimi i degës së siguruesit të jashtëm në subjekt të varur

1. Siguruesi, i cili ushtron veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet degës së tij, në bazë të licencës së lëshuar nga BQK-ja, mund të shndërrojë degën e saj në një subjekt të varur, në formën e shoqërisë aksionare.
2. Shndërrimi i degës së siguruesit në subjekt të varur, mund të bëhet me kërkesë të vetë siguruesit ose kur vlerësohet e nevojshme nga BQK-ja.
3. BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi i jashtëm, që është licencuar për të operuar në një ose më shumë degë në Kosovë, që ta shndërrojë degën në subjekt të varur të siguruesit të jashtëm nëse:

- 3.1. ekziston ndonjë ndryshim material në pronësinë apo menaxhmentin e siguruesit të jashtëm për të cilën BQK-ja ka arsye të bazuara për shqetësim;
 - 3.2. ekziston rënie materiale në gjendjen financiare të siguruesit të jashtëm apo i nënshtrohet sanksioneve nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit amë, për shkelje materiale të ligjit ose praktikave të pasigurta dhe të pamatura;
 - 3.3. konsideron se operacionet e degës së siguruesit të jashtëm në Kosovë, mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të sektorit të sigurimeve ose mund të jenë të dëmshme për interesin e policëmbajtësve;
 - 3.4. konsideron se mbikëqyrja nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë është joadekuate, dhe;
 - 3.5. për arsye të menaxhimit të rrezikut.
4. BQK-ja mund të nxjerr rregullore në lidhje me shndërrimin e degëve të siguruesve të jashtëm në subjekte të varura.
 5. Procedura për shndërrim të degës së siguruesit të jashtëm në subjekt të varur, zhvillohet njësoj sikurse tek aplikimi për licencë të një siguruesi, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të procedurës së miratimit paraprak, e cila nuk aplikohet në këto raste.
 6. Vendimi për shndërrimin e degës së siguruesit të jashtëm, kur shndërrimi kërkohet nga siguruesi i jashtëm, duhet të merret nga asambleja e përgjithshme ose organi tjetër kompetent i atij siguruesi.
 7. Në rastin kur siguruesi kërkon që degën ta shndërrojë në subjekt të varur, siguruesi duhet ta marrë edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit të tij.
 8. Pas aprovimit të shndërrimit dhe lëshimit të licencës së re, të gjitha të drejtat dhe obligimet e degës së siguruesit të jashtëm, i kalojnë subjektit të varur pasardhës.
 9. Subjekti pasardhës duhet t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në regjistrin e bizneseve dhe tek organet tjera.
 10. Subjekti pasardhës duhet t'i informojë policëmbajtësit për shndërrimin, duke i njoftuar se është pasardhëse e degës së siguruesit të jashtëm dhe se ky shndërrim nuk do të ketë kurrfarë pasoja për ata.
 11. Një njoftim për publikun lidhur me shndërrimin do të publikohet për pesë (5) ditë me radhë, në media për informim të publikut, që mbulojnë tërë territorin e Republikës së Kosovës, me shpenzimet e subjektit të varur pasardhës.

Neni 16 **Revokimi i Licencës**

1. Licenca e një siguruesi mund të revokohet me vendim të BQK-së, për një apo më shumë prej arsyeve në vijim:

- 1.1. nëse BQK-ja ka miratuar planin që siguruesi të përfundojë veprimtarinë në Kosovë dhe siguruesi i është përmbajtur atij plani;
- 1.2. nëse sipas vlerësimit të BQK-së, siguruesi është angazhuar në praktika të pasigurta ose jo të shëndosha;
- 1.3. nëse licenca është lëshuar në bazë të informacioneve dhe dokumentacioneve të pasakta të ofruara;
- 1.4. nëse siguruesi nuk ka filluar të funksionojë brenda tre (3) muajve pas marrjes së licencës apo brenda një periudhe vijuese të caktuar nga BQK-ja dhe nëse ka pushuar të merret me veprimtarinë e sigurimit për më shumë se tre (3) muaj;
- 1.5. nëse një siguruesi tjetër, që mban interes të konsiderueshëm në këtë sigurues i është revokuar licenca, e që mund të ndikoj në performancën e siguruesit në Kosovë;
- 1.6. nëse ka ndodhur bashkimi, shkrirja ose shitja e pjesës më të madhe të pasurisë së siguruesit;
- 1.7. nëse aktivitetet e siguruesit ndryshojnë në thelb nga ato të paraqitura në kërkesën për licencë dhe sipas vlerësimit të BQK-së, ky ndryshim nuk është arsyetuar e as nuk është dhënë miratimi nga BQK-ja për ndryshimet e tilla;
- 1.8. nëse i licencuari është një degë e siguruesit të jashtëm dhe siguruesi i jashtëm e ka humbur të drejtën për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në vendin ku është vendosur drejtoria e saj qendrore, apo;
- 1.9. nëse ka pasur ndryshim në aksionarët kryesorë pa miratimin e BQK-së siç kërkohet me këtë ligj.

2. Licenca revokohet me vendim të BQK-së edhe nëse ajo konstaton se siguruesi është josolvent.

3. Vendimi i BQK-së për të revokuar licencën i komunikohet me shkrim siguruesit, duke dhënë arsyet e vendimit.

4. Vendimi për të revokuar një licencë nga BQK-ja, publikohet në një apo më tepër mjete të informimit për publikun.

Neni 17

Kërkesat për zgjerim të veprimtarisë nga siguruesit

1. Siguruesi, i cili ka marrë licencë për të ushtruar veprimtari në klasa të caktuara të sigurimit dhe që kërkon të ushtrojë veprimtari në klasa të tjera të sigurimit, duhet të marrë licencë për zgjerim veprimtarie për klasat që dëshiron të licencohet.

2. BQK-ja mund të nxjerr rregullore për kriteret dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave për zgjerim të veprimtarisë së siguruesve.

Neni 18**Informimi për fillimin apo ndërprerjen e veprimtarisë së sigurveesit**

Sigurveesi informon menjëherë BQK-në për fillimin apo ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit për klasën e caktuar të sigurimit, për të cilën ka marrë licencë në përputhje me këtë ligj.

KAPITULLI III**KËRKESA PËR KAPITAL****Neni 19****Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i të gjithë sigurveesve të licencuar për ushtrimin e aktivitetit sigurvees në Kosovë për sigurimet jo-jetë nuk mund të jetë më i ulët se dy milion e dyqind mijë (2,200,000) euro. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të nenit 7 të këtij ligji, atëherë kapitali themeltar nuk mund të jetë më i ulët se tre milion e dyqindmijë (3,200,000) euro.

2. Përveç kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, sigurveesi duhet të ketë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet përqind (20%) e kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Aksionarët depozitojnë për llogari të sigurveesit vlerën përkatëse në para të gatshme të kapitalit themeltar dhe fondin për shpenzimet fillestare të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, në një llogari të besuar, në një nga bankat e licencuara në Republikën e Kosovës. Kapitali sipas paragrafit (1) të këtij neni paguhet plotësisht përpara marrjes së licencës përfundimtare.

4. Kapitali themeltar i sigurveesit nuk mund të përdoret si kolateral për të marrë kredi apo për ndonjë aktivitet tjetër të sigurveesit.

Neni 20**Burimet e Kapitalit**

1. Aksionarët e sigurveesit i japin BQK-së informacion për burimin e kapitalit themeltar të paguar për themelimin e sigurveesit, si dhe për çdo shtesë të kapitalit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së sigurveesit.

2. Për të vërtetuar burimin e parave për kapitalin themeltar dhe shtesën e këtij kapitali në BQK, dorëzohet dokumentacioni i mëposhtëm:

2.1. për personat juridikë:

2.1.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të sigurveesit;

2.1.2. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e

personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.

2.2. për personat fizikë:

2.2.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

2.2.2. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;

2.2.3. kontributet për kapitalin e siguruesit nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare si dhe fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.

3. Me qëllim parandalimin e pastrimit të parave, BQK-ja mund të bashkëpunojë me Njësinë për Inteligjencë Financiare të Kosovës apo me ndonjë autoritet tjetër të lëmisë së zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës. BQK-ja mund të kërkojë informacione shtesë nga aksionarët gjatë verifikimit të burimit të kapitalit.

4. Nëse prejardhja e kapitalit themeltar nuk është e qartë për BQK-në, kjo përbën bazë për refuzim të licencës.

5. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të dispozitave të këtij neni.

Neni 21

Ekuiteti

1. Siguruesit janë të obliguar që gjatë periudhave të raportimit financiar, niveli i ekuitetit nuk mund të jetë më pak se kapitali themeltar.

2. Në rast se niveli i ekuitetit bie nën nivelin e kapitalit themeltar, atëherë aksionari është i obliguar që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, të shtojë kapital shtesë me qëllim të mbulimit të humbjes.

KAPITULLI IV

QEVERISJA E SIGURUESVE DHE RISIGURUESVE

Neni 22

Organizimi i siguruesve

1. Siguruesit do të themelohen si shoqëri aksionare dhe regjistrohen në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe pronësinë e shoqërisë aksionare, që gjenden në Ligjin përkatës për shoqëritë tregtare, të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë ligj, zbatohen edhe për siguruesit.

Neni 23

Akti i Themelimit dhe Statuti

1. Të gjithë siguruesit që ushtrojnë veprimtari sigurimi në Kosovë, duhet ta kenë aktin e themelimit dhe statutin, një kopje e të cilave duhet të miratohet nga BQK-ja. Asnjë sigurues, përveç degës së siguruesit të jashtëm të licencuar në Kosovë, nuk mund të ndryshojë aktin e saj të themelimit dhe statutin pa miratimin paraprak me shkrim të BQK-së.

2. Dega e siguruesit të jashtëm e licencuar në Kosovë, duhet ta njoftojë BQK-në për çdo ndryshim në aktin e saj të themelimit, statutin apo në dokumentacionin ekuivalent të themelimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data efektive e ndonjë ndryshimi.

3. Çdo sigurues, përfshirë degën e siguruesit të jashtëm, mban në BQK, një kopje të vërtetuar të aktit të themelimit apo dokumentacionit ekuivalent të themelimit, statutin dhe listën e zyrtarëve të siguruesit, bashkë me ekzemplarin e nënshkrimeve dhe përshkrimin e kompetencave të tyre.

Neni 24

Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur

1. Çdo aksionar kryesor, drejtor, menaxher i lartë si dhe aktuari i siguruesit duhet të përmbushin kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur, në lidhje me pozicionin përkatës dhe kërkohet të aprovohet nga BQK-ja.

2. BQK-ja vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe i duhur për të mbajtur pozicionin përkatës të siguruesi, bazuar në kriteret e mëposhtme:

2.1. historiku penal;

2.2. integriteti, ndershmëria dhe përkushtimi në përmbushjen e detyrave të tij;

2.3. kompetenca, aftësi profesionale dhe gjykimi i shëndoshë në përmbushjen e detyrave të tij;

2.4. pavarësia në mënyrë që të mos cenohen interesat e siguruesit nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur duhet të aplikohen nga personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni gjatë gjithë kohës.

4. BQK-ja mund të rregullojë dhe caktojë edhe kritere tjera për vlerësimin e përshtatshmërisë së personave nga ky nen.

Neni 25

Organet e siguruesve

1. Organet e siguruesve janë:

1.1. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve;

1.2. Bordi i drejtorëve; dhe

1.3. Menaxhmenti i lartë.

Neni 26

Asambleja e përgjithshme e aksionarëve

1. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve të siguruesit përbëhet nga të gjithë aksionarët.
2. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve mbahet së paku një herë në vit ose me shpesh sipas kërkesës së aksionarëve, bordit të drejtorëve apo me urdhër të BQK-së.
3. Bordi i drejtorëve, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë ligj, thërret asamblenë e përgjithshme të aksionarëve.
4. Çdo aksionar i cili është vendosur në listën e aksionarëve në regjistër, tridhjetë (30) ditë para datës së seancës së asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, ka të drejtë vote në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve.
5. Siguruesi mbulon shpenzimet e seancës të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve.
6. Kërkesa për thirrjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve mund të paraqitet nga:
 - 6.1. aksionari ose grupi i aksionarëve me më shumë se dhjetë përqind (10%) të numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote;
 - 6.2. së paku dy (2) anëtarë të bordit të drejtorëve.
7. Kërkesa për thirrjen e Asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, me propozimin për rendin e ditës, i dorëzohet bordit të drejtorëve në formë të shkruar.
8. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve të siguruesit ka përgjegjësi:
 - 8.1. krijimin e kapitalit fillestar nëpërmjet emetimit ose rritjes së aksioneve të zakonshme dhe emetimit ose rritjes së aksioneve të preferuara;
 - 8.2. zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të bordit të drejtorëve;
 - 8.3. emrin dhe adresën e selisë qendrore të siguruesit;
 - 8.4. kompensimet për anëtarët e bordit të drejtorëve;
 - 8.5. emëron auditorin e jashtëm, dhe;
 - 8.6. raportet vjetore financiare me raportin e auditorit të jashtëm;
 - 8.7. vendime tjera siç përcaktohet me statutin e siguruesit.

9. Aspektet tjera të Asamblesë së përgjithshme të aksionareve qeverisen sipas ligjit në fuqi për shoqëritë tregtare, për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 27 **Bordi i Drejtorëve**

1. Bordi i drejtorëve të siguruesit përbëhet nga numri tek, jo më pak se pesë (5) anëtarë me të drejtë vote, që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e përgjithshme e aksionarëve, me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

2. Përveç kryeshefit ekzekutiv, i cili sipas detyrës zyrtare është anëtar i bordit të kompanisë, të gjithë anëtarët e tjerë të bordit të drejtorëve duhet të jenë drejtor joekzekutiv.

3. Bordi i drejtorëve zgjedh kryesuesin e tij, nga radha e njërit prej anëtarëve joekzekutiv të tij:

3.1. kryeshefi ekzekutiv është anëtar i bordit të drejtorëve sipas detyrës zyrtare pa të drejtë vote;

3.2. çdo anëtar i bordit të drejtorëve të siguruesit, duhet që t'i plotësojë kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur nga neni 24 i këtij ligji.

4. Zyrtarët e lartë publik, mund të shërbejnë si anëtarë të bordit të drejtorëve të ndonjë siguruesi, duke iu nënshtruar kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

5. Ky nen nuk aplikohet për degën e siguruesit të jashtëm.

6. Anëtarët e bordit të drejtorëve i informojnë aksionarët për konfliktin e mundshëm të interesit.

Neni 28 **Detyrat e Bordit të drejtorëve**

1. Bordi i drejtorëve të siguruesit, siguron se veprimtaritë e siguruesit kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore të BQK-së, si dhe rregullat dhe procedurat e brendshme të siguruesit.

2. Pa paragjykuar ushtrimin e aktiviteteve sipas paragrafit 1 bordi i drejtorëve të siguruesit është përgjegjës:

2.1. të aprovojë strukturën organizative të siguruesit;

2.2. të emërojë dhe shkarkojë manaxherët e lartë të siguruesit;

2.3. të mbikëqyrë punën e manaxherëve të lartë të siguruesit;

2.4. të aprovojë strategjinë afariste dhe buxhetin vjetor të siguruesit;

2.5. të aprovojë politika dhe procedura, në pajtim me të cilat siguruesi ushtron aktivitetin

e tij, duke përfshirë në veçanti politikat dhe procedurat lidhur me menaxhimin e rrezikut;
2.6. të krijojë politika dhe procedura për të trajtuar konfliktet e interesit dhe të sigurojë zbatimin e tyre;

2.7. të sigurojë vendosjen, funksionalizimin, përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe menaxhimin e rrezikut të siguruesit;

2.8. të sigurojë vendosjen e funksionit të përshtatshëm të auditimit të brendshëm;

2.9. të propozojë auditorin e jashtëm dhe pas aprovimit nga BQK-ja, i propozon asamblesë së përgjithshme të aksionarëve për emërim;

2.10. të sigurojë se siguruesi ka kryer auditimin vjetor të jashtëm, i cili përfshin mendimin e auditorit rreth vërtetësisë dhe saktësisë së pasqyrave financiare të siguruesit;

2.11. të krijojë dhe vendosë një politikë të përshtatshme të kompensimit për menaxhmentin e lartë. Politika duhet të marrë parasysh performancën e menaxhmentit të lartë dhe siguruesit dhe nuk duhet të përfshijë stimulimet të cilat do të inkurajonin një sjellje të pamatur;

2.12. të kryejë funksione tjera, ashtu siç përcaktohet në statutin e siguruesit;

2.13. shqyrton pasqyrat vjetore të siguruesit, përpara se këto pasqyra të miratohen nga organet drejtuese të tij;

2.14. shqyrton raporte tjera financiare të përcaktuara nga BQK-ja.

Neni 29

Mbledhjet e Bordit të drejtorëve

1. Bordi i drejtorëve mblidhet sipas nevojës, por jo më pak se një herë në tre (3) muaj.
2. BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi, që të mbajë mbledhje të posaçme të bordit të drejtorëve, nëse e konsideron këtë të nevojshme, për të shqyrtuar çështjet e paraqitura me shkrim nga BQK-ja.
3. Vendimet e bordit të drejtorëve janë valide kur janë të pranishëm dhe votojnë shumica e anëtarëve të tij.
4. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave, të së paku shumicës së anëtarëve të pranishëm që përbejnë kourumin, me përjashtim të rasteve kur në statutin e siguruesit kërkohet një shumicë më e lartë për marrjen e vendimeve.

Neni 30

Komitetet e Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i drejtorëve duhet të themelojë komitetin e auditimit, komitetin për menaxhimin e rrezikut dhe komitetin për menaxhim të investimeve.

2. Siguruesi mund të themelojë edhe komitete tjera sipas vlerësimit të tij. BQK-ja në kuadër të kompetencave të saj, mund të kërkojë nga siguruesi të themelojë komitete të posaçme.

3. Siguruesi do ta themelojë komitetin e auditimit, i cili përbëhet nga jo më pak se tre (3) anëtarë, shumica nga të cilët duhet të jenë anëtar joekzekutiv të bordit të drejtorëve të siguruesit dhe një nga anëtarët e komitetit të auditimit duhet të jetë ekspert i jashtëm, i cili duhet të ketë jo më pak se tre (3) vjet përvojë në fushën e financave, kontabilitetit dhe auditimit.

4. Komiteti i auditimit, ndër të tjera ka edhe këto detyra:

4.1. monitoron procesin e raportimit financiar;

4.2. monitoron raporte tjera financiare të përcaktuara nga BQK-ja;

4.3. i rekomandon siguruesit të mbajë dhe të zbatojë procedura të brendshme për menaxhimin e siguruesit, si dhe shqyrton dhe vlerëson këto procedura;

4.4. shqyrton investimet dhe transaksionet, të cilat mund të kenë efekte negative mbi mbarëvajtjen e siguruesit, të sugjeruara nga auditori i brendshëm apo çdo person përgjegjës brenda siguruesit;

4.5. propozon udhëheqësin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm;

4.6. jep rekomandim për emërimin e auditorit të jashtëm dhe monitoron pavarësinë e tij;

4.7. shqyrton procedurat për kontrollin e brendshëm.

5. Komiteti i auditimit mblidhet jo më pak se katër (4) herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga bordi i drejtorëve të siguruesit. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm.

6. Komiteti i auditimit i raporton bordit të drejtorëve dhe e ndihmon këtë të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës të siguruesit.

7. Bordi i drejtorëve të çdo siguruesi do ta themelojë komitetin për menaxhim të rrezikut, i cili përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë nga bordi i drejtorëve. Komiteti për menaxhim të rrezikut ndihmon bordin e drejtorëve në zhvillimin, aprovimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave për menaxhim të rrezikut të siguruesit. Në veçanti, ky komitet duhet:

7.1. të rishikojë dhe vlerësojë politikat, strategjitë dhe procedurat e propozuara për menaxhim të rrezikut të siguruesit dhe bën rekomandime për bordin e drejtorëve lidhur me aprovimin e tyre;

7.2. të ndihmojë bordin e drejtorëve për të siguruar se programi për menaxhim të rrezikut i siguruesit, zbatohet në përputhje me politikat, strategjitë dhe kufijtë e aprovuar nga bordi i drejtorëve dhe me ligjet në fuqi, si dhe me rregulloret të BQK-së;

7.3. të monitorojë zbatimin e këtyre politikave dhe strategjive, nëpërmjet pranimi të raporteve nga menaxhmenti i lartë dhe njësia për menaxhim të rrezikut, në kuadër të siguruesit;

7.4. të rishikojë periodikisht politikat dhe strategjitë për menaxhim të rrezikut të siguruesit dhe t'i rekomandojë bordit të drejtorëve ndonjë ndryshim, që komiteti e konsideron të nevojshme, dhe;

7.5. të kryejë detyra tjera që i caktohen nga bordi i drejtorëve e që kanë të bëjnë me programin për menaxhim të rrezikut të siguruesit.

8. Bordi i drejtorëve i çdo siguruesi do të themelojë komitetin për menaxhim të investimeve, i cili përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë, prej të cilëve njëri duhet të jetë anëtar joekzekutiv i bordit të drejtorëve.

9. Ky nen nuk zbatohet për siguruesin e jashtëm, për aq sa kërkesat e krahasueshme dhe të pranueshme për BQK-në, zbatohen me legjislacionin, sipas të cilit siguruesi i jashtëm është licencuar në shtetin amë.

10. BQK-ja mund të miratojë rregulla të tjera për mënyrën e funksionimit të komiteteve të bordit të drejtorëve të siguruesit.

Neni 31 **Menaxhmenti i lartë**

1. Kryeshefi ekzekutiv duhet të jetë rezident dhe emërohet nga bordi i drejtorëve të siguruesit.

1.1. Kryeshefi ekzekutiv i siguruesit:

1.1.1. është përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së siguruesit dhe zbatimin e strategjisë së përcaktuar të aktivitetit të siguruesit;

1.1.2. përfaqëson siguruesin dhe vepron si përfaqësues ligjor i tij;

1.1.3. zbaton vendimet e mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve, komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve;

1.1.4. organizon dhe menaxhon veprimtaritë e përditshme të siguruesit;

1.1.5. merr vendime për të gjitha çështjet të cilat nuk janë në kompetencë të mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve, komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve të siguruesit, dhe;

1.1.6. kryen funksione tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e siguruesit.

2. Zëvendëskryeshefi ekzekutiv zëvendëson kryeshefin ekzekutiv në mungesë të tij dhe nëse siguruesi nuk ka zëvendëskryeshef të emëruar, atëherë kryeshefi ekzekutiv autorizon me shkrim njërin nga menaxherët e lartë, që ta zëvendësojë atë dhe t'i ushtrojë kompetencat e tij,

përkohësisht.

3. Të gjithë menaxherët e lartë i raportojnë bordit të drejtorëve për çdo interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me individët e ndërlidhur apo me ndonjë person juridik, me të cilin siguruesi ka hyrë ose ka ndërmend të hyjë në marrëdhënie afariste.

Neni 32

Kualifikimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

1. Çdo drejtor dhe menaxher i lartë i siguruesit duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm me reputacion të mirë, i cili duhet t'i plotësojë kriteret e përcaktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin.

2. Përveç siç është përcaktuar në nenin 24 të këtij ligji, personi nuk konsiderohet i përshtatshëm nëse i njëjti:

2.1. është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;

2.2. është larguar nga posti i një siguruesi me kërkesë të BQK-së;

2.3. me vendim të organeve kompetente i është hequr ose pezulluar e drejta e ushtrimit të profesionit;

2.4. ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një siguruesi, licenca e të cilit është revokuar apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruar i atij siguruesi është iniciuar gjatë mandatit të tij.

3. Një person konsiderohet i kualifikuar, nëse ai person është i diplomuar në nivel universitar dhe ka përvojë të duhur, siç përcakton BQK-ja me rregullore.

4. Një person nuk mund të emërohet apo të zgjidhet si drejtor ose menaxher i lartë i siguruesit, nëse ai person ka shërbyer gjatë gjashtë (6) muajve të mëparshëm në BQK.

5. Siguruesit, sapo të vihen në dijeni të rrethanave të cilat tregojnë se ndonjë drejtor ose menaxher i lartë mund të mos jetë person i përshtatshëm dhe i duhur, duhet ta njoftojë menjëherë BQK-në.

Neni 33

Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

1. Asnjë person nuk mund të ushtrojë funksionin e anëtarit të bordit të drejtorëve apo si menaxher i lartë të një sigurues, nëse paraprakisht nuk është marrë aprovimi me shkrim nga BQK-ja.

2. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet për degën e siguruesit të jashtëm vetëm në lidhje me menaxherët e lartë.

Neni 34

Konflikti i interesit dhe transaksionet me palë të ndërlidhura

1. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të shmangin interesin privat, i cili krijon konflikt me interesin e siguruesit.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, drejtorët e informojnë paraprakisht asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, ndërsa menaxherët e lartë e informojnë bordin e drejtorëve, nëse ata kanë interesa private të tilla, që ndikojnë gjykimin e tyre për transaksione apo çështje të caktuara, duke krijuar konflikt interesi. Interesat private janë ato interesa që bazohen ose burojnë nga:

2.1. marrëdhënie pasurore e drejtpërdrejtë ose e tërthortë të çdo lloj natyre;

2.2. çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

2.3. dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

2.4. angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura;

2.5. marrëdhënie me palë të ndërlidhura.

3. Deklarimi i interesave private sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni, i njoftohen me shkrim asamblesë së përgjithshme dhe bordit të drejtorëve, jo më pak se një herë në vit.

4. Marrëdhëniet dhe transaksionet biznesore me palë të ndërlidhura, në të cilat anëtari i bordit të drejtorëve ka interes, duhet të kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut.

5. Siguruesi duhet të hartojë procedura për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të cilat duhet të përfshijnë informimin për konfliktin e mundshëm të interesit, kërkesa të veçanta për transaksionet që duhet të kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut, si dhe kur gjykohet e përshtatshme, marrja e miratimit paraprak të bordit të drejtorëve apo të asamblese së përgjithshme të aksionareve për kryerjen e këtyre transaksioneve.

6. Bordi i drejtorëve mund të ngrejë dhe të autorizojë komitete të posaçme, të cilët ngarkohen me përgjegjësinë për trajtimin e konfliktit të interesit.

7. Siguruesi krijon një sistem të përshtatshëm kontrolli të brendshëm, për transaksionet me persona ose palë të ndërlidhura, ku përfshihet monitorimi i kontratave, marrëveshjeve afatgjata apo marrëveshje të një rëndësie të veçantë për siguruesin për sa i përket konfliktit të interesit.

8. Në rastin e mosdeklarimit të konfliktit të interesit, sipas këtij neni ose kur kontrata apo veprimi juridik është lidhur në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit, merren masat e mëposhtme:

8.1. Bordi i drejtorëve dhe çdo aksionar i siguruesit, ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës deklarimin e pavlefshmërisë së kontratës ose të veprimit tjetër juridik;

8.2. BQK-ja ka të drejtë t'i kërkojë siguruesit shkarkimin e personit në fjalë.

9. Dispozitat e këtij neni për siguruesin e jashtëm, zbatohet vetëm për menaxherët e lartë të tij.

Neni 35

Kërkesat për aksionarët kryesorë

1. Zotërimi i aksioneve në një sigurues, ku një aksionar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi arrin ose tejkalon nivelin e të qenit aksionar kryesor, bëhet vetëm me miratim paraprak të BQK-së pas paraqitjes së kërkesës për të qenë aksionar kryesor.

2. BQK-ja, përveç siç është parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni, miraton çdo zotërim të mëtejshëm të aksioneve që janë të barabarta ose tejkalojnë dhjetë përqind (10%), njëzet përqind (20%), tridhjetë përqind (30%) dhe pesëdhjetë përqind (50%) të drejtave të votës ose pjesëmarrjes në kapitalin e siguruesit.

3. Aksionari, i cili ka marrë miratimin e parashikuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, njofton paraprakisht BQK-në nëse ai kërkon zvogëlimin e pjesëmarrjes së tij në aksione.

4. BQK-ja mund të përcaktojë rregulla mbi aksionarët kryesorë me prejardhje nga vendet tjera, si dhe mbi bashkëpunimin e BQK-së me autoritetet mbikëqyrëse të këtyre vendeve.

5. BQK-ja mund t'i miratojë aksionarët kryesorë, nëse plotësohen kërkesat e parashikuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe refuzon aprovimin për aksionarët kryesorë nëse gjykon se:

5.1. veprimet e kryera në të kaluarën nga aksionari kryesor apo personat/palët e ndërlidhura me të mund të përkeqësojnë veprimtarinë e siguruesit në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut apo mund të vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja;

5.2. në rastin e kërkesës nga aksionarët kryesorë të jashtëm, zbatimi i legjislacionit apo praktikave të legjislacionit të vendit të tij, vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja.

6. BQK-ja, nëse gjykon se një person, i cili është aksionar kryesor në një sigurues vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji dhe me rregullat për menaxhimin e kujdesshëm e të përshatshëm të siguruesit, merr masat e duhura për përfundimin e kësaj situate.

KAPITULLI V

TRANSFERIMI I PORTOFOLIT DHE DELEGIMI I FUNKSIONEVE

Neni 36

Transferimi i portofolit të sigurimit

1. Siguruesi me miratim të BQK-së, mund të transferojë nëpërmjet një marrëveshjeje të një sigurues tjetër, të gjitha ose një pjesë të portofolit të saj të sigurimit, të nënshkruara në një apo disa klasa të caktuara të sigurimit me të gjitha detyrimet dhe të drejtat. Për qëllime të këtij ligji, siguruesi i cili i transferon portofolin e sigurimit, quhet sigurues transferues, kurse siguruesi tek i cili transferohen kontratat e sigurimit, quhet sigurues pranues.

2. Siguruesi përveç siç është parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni, transferon edhe aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, të barabarta me provizionet teknike dhe matematike të përlogaritura, për të mbuluar përgjegjësitë e portofolit të sigurimit që do të transferohen.
3. Portofoli i sigurimit mund të transferohet te siguruesi pranues, pasi kjo e fundit ka marrë miratimin e BQK-së për të pranuar portofolin e sigurimeve.
4. Për transferimin e portofolit të sigurimit nuk kërkohet miratimi i të siguruarve.
5. Siguruesi pranues njofton të siguruarit për transferimin e portofolit të sigurimit, me anë të mjeteve publike të komunikimit, në territorin ku ndodhet rreziku i mbuluar nga kontratat e sigurimit të transferuara, brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga data e miratimit të BQK-së për transferim të portofolit.
6. Siguruesi mund të transferojë portofolin e saj të sigurimit te:
 - 6.1. siguruesi me seli qendrore në Republikën e Kosovës, i licencuar nga BQK-ja;
 - 6.2. dega e një siguruesi të jashtëm, e licencuar nga BQK-ja.
7. Siguruesi transferues paraqet në BQK, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e transferimit të portofolit, një dokument që vërteton se transferimi është finalizuar.
8. Nëse transferimi i portofolit nuk është realizuar sipas marrëveshjes, BQK-ja mund ta tërheqë miratimin.

Neni 37

Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit

1. Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit bëhet me shkrim nga siguruesi transferues dhe përmban:
 - 1.1. miratimin e transferimit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe bordit të drejtorëve të siguruesit transferues;
 - 1.2. miratimin e transferimit të siguruesit pranues nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe bordi i drejtorëve të tij;
 - 1.3. listën e kontratave të sigurimit, të ndara sipas klasave të sigurimit, së bashku me kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të tyre, që kërkohen të transferohen si dhe llogaritjet e provizioneve teknike dhe matematike për klasat e sigurimit në fjalë;
 - 1.4. aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, përfshirë këtu vlerën e tyre përkatëse, si dhe të gjitha të dhënat që mund të përdoren për verifikimin e llogaritjes së këtyre vlerave;
 - 1.5. planin e ndryshuar të biznesit që nevojitet për transferimin e portofolit të sigurimit, të siguruesit pranues;

1.6. kontratën e transferimit të portofolit të sigurimit;

1.7. afatin kohor për transferimin e portofolit.

Neni 38

Miratimi dhe refuzimi i kërkesës për transferimin e portofolit të sigurimit

1. BQK-ja brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e pranimit të kërkesave të plotësuara sipas parashikimeve të neneve 36 dhe 37 të këtij ligji, miraton ose refuzon transferimin e portofolit të sigurimit.

2. Në rastin kur siguruesi pranues është degë e një siguruesi të jashtëm, BQK-ja merr vendim për miratim, vetëm nëse autoriteti mbikëqyrës i vendit amë, jep miratimin me shkrim.

3. BQK-ja refuzon kërkesën për transferimin e portofolit të sigurimit nëse:

3.1. siguruesi pranues nuk është i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e sigurimeve, që i përkasin portofolit të sigurimit që transferohet;

3.2. vlera e aktiveve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike të siguruesit pranues është më e ulët sesa vlera e provizioneve, që duhet të krijoheshin kundrejt portofolit të sigurimit, që do të transferohet.

3.3. siguruesi pranues nuk plotëson kërkesat ligjore për klasat e sigurimeve, që i përkasin portofolit që transferohet ose në qoftë se me pranimin e portofolit veprimtaria e siguruesit pranues në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut mund të përkeqësohet.

4. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore, përmes së cilës përcakton kërkesa shtesë, në lidhje me transferimin e portofolit të sigurimit.

Neni 39

Miratimi i delegimit të funksioneve

1. Siguruesi mund të delegojë funksionet, pasi të ketë marrë miratimin paraprak me shkrim të BQK-së.

2. Funksionet e siguruesit mund të delegohen, vetëm nëpërmjet një kontrate të shkruar, në bazë të cilës siguruesi transferon një pjesë të funksioneve të saj, te një person tjetër.

3. Kontrata për delegimin e funksioneve duhet të përmbajë një dispozitë, e cila përcakton se siguruesi që delegon përgjegjësinë është përgjegjëse për funksionet e transferuara te personi tjetër. Kontrata për delegimin e funksioneve, po ashtu duhet të përcaktojë se personi pranues i funksioneve të deleguara, do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e BQK-së.

4. BQK-ja mund të refuzojë apo tërheq miratimin e delegimit të funksioneve nëse:

4.1. rrezikohen interesat e të siguruarve;

4.2. vështirësohet ose bëhet e pamundur mbikëqyrja në lidhje me funksionet e deleguara;

4.3. pranuesi i funksioneve të deleguara, nuk ka kompetencë për funksionet e deleguara.

5. BQK-ja me akte nënligjore, mund të përcaktojë kushte dhe kritere shtesë për delegimin e funksioneve.

Neni 40

Mbikëqyrja e ushtrimit të funksioneve të deleguara

1. Dispozitat e këtij ligji për mbikëqyrjen e siguruesit, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për mbikëqyrjen e personit që ushtron funksionet e deleguara.

2. Siguruesi dhe personi që ushtron funksionet e deleguara, me kërkesën e BQK-së, paraqet të dhëna mbi statusin juridik, gjendjen financiare dhe veprimtarinë e personit, e cila ka nënshkruar kontratën për delegimin e funksioneve si dhe çdo dokument dhe informacion tjetër të kërkuar nga BQK-ja.

3. Auditori i jashtëm i siguruesit, ka të drejtë t'i kërkojë personit që ushtron funksionet e deleguara çdo informacion që lidhet me kryerjen e auditimit.

KAPITULLI VI

BASHKIMET DHE PËRVETËSIMET

Neni 41

Bashkimet dhe përvetësimet e siguruesit

1. Asnjë sigurues nuk mund të bashkohet me ndonjë sigurues tjetër ose të përvetësojë, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, aktiven apo të pranojë pasivën e ndonjë siguruesi tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së.

2. Kërkesat për t'u bashkuar dhe përvetësuar aktivën apo për të pranuar pasivën e siguruesit, bëhen në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe shoqërohen nga informacionet të cilat kërkohen nga BQK-ja.

3. Siguruesi i licencuar për sigurim jete, paraqet në BQK një raport të hartuar nga aktuari, që vërteton se bashkimi ose përvetësimi nuk është në kundërshtim me interesat e të siguruarve dhe siguruesve të përfshirë në këto procese.

4. Për qëllimet e vendosjes lidhur me kërkesën e parashtruar sipas këtij neni, dispozitat e këtij ligji për licencim të siguruesve, aplikohen përshtatshëmrisht.

5. BQK-ja para se të vendosë për bashkimin e siguruesve, mund të kërkojë mendimin e agjencionit të konkurrencës.

6. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore tjera, në zbatimin e këtij kapitulli.

KAPITULLI VII NDRYSHIMI I KAPITALI DHE EMRIT

Neni 42

Miratimi i ndryshimeve në kapital të siguruesit

1. Çdo ndryshim i kapitalit të siguruesit, i nënshtrohet aprovimit paraprak nga BQK-ja.
2. Në rastin e rritjes së kapitalit, siguruesi dorëzon në BQK, të dhëna për burimin e kapitalit.
3. Nëse rritja e kapitalit të siguruesit bëhet nga burime të brendshme të tij, siguruesi dorëzon në BQK të dhënat e kërkuara në lidhje me burimin e rritjes së kapitalit përfshirë edhe një vërtetim të lëshuar nga auditori i jashtëm i siguruesit, që vërteton mjaftueshmërinë e këtyre burimeve brenda strukturës së siguruesit.
4. BQK-ja mund të kërkojë rritjen e kapitalit, nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

Neni 43

Ndryshimi i emrit

Ndryshimi i emrit të siguruesve i nënshtrohet miratimit paraprak nga BQK-ja. Siguruesi duhet t'i njoftojë të siguruarit për ndryshimin e emrit.

KAPITULLI VIII KONTRATAT E SIGURIMIT

Neni 44

Kontrata e sigurimit

1. Kontrata e sigurimit është akti, nëpërmjet së cilit siguruesi merr përsipër rreziqe të caktuara, përkundrejt pagesës së primit, që me rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguar t'i paguajë të siguruarit, përfituesit apo palës së tretë dëmshpërblimin.
2. Kontratat e sigurimit duhet t'i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve në fuqi.

Neni 45

Forma e kontratës së sigurimit

1. Kontrata e sigurimit bëhet me shkrim, në formën e policës së sigurimit apo në formën e një akti tjetër të shkruar.
2. Kërkesat dhe propozimet me shkrim të të siguruarit, drejtuar siguruesit për të lidhur një kontratë sigurimi, si dhe përgjigjet me shkrim të të siguruarit për pyetjet e bëra nga siguruesi për rrethanat e rëndësishme, që kanë të bëjnë me vlerësimin e natyrës dhe masës së rrezikut, janë pjesë përbërëse e dosjes. Në kontratë përfshihen elementet për të cilat janë dakorduar siguruesi dhe i siguruari.

Neni 46**Kushtet dhe përmbajtja e kontratës së sigurimit**

1. Kontrata e sigurimit përmban kushtet e përgjithshme, të hartuara në bazë të parimeve të mëposhtme:

1.1. personi, i cili do të lidhë kontratën, duhet të ketë një interes të siguroeshëm dhe të pretendojë të drejtat që rrjedhin nga kontrata;

1.2. shuma e siguruar mund të jetë deri në vlerën e interesit të siguroeshëm, por jo më e lartë se kjo vlerë, përveç se kur natyra e veprimtarisë/rrezikut e kërkon atë;

1.3. dëmet e ndodhura si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme dhe të qëllimshme të të siguarit nuk mbulohen;

1.4. rreziqet të cilat kanë ndodhur dhe/ose dihet që kanë ndodhur, nuk mund të sigurohen;

1.5. një interes i siguruar për vlerën e tij të plotë, nuk mund të sigurohet nga i njëjti siguroes më shumë se një herë, përveç se kur siguroesi në fjalë apo siguroesi tjetër janë plotësisht të informuar dhe kanë rënë dakord për detyrimet ndaj njëri-tjetrit;

1.6. personat, të cilët kanë përfitime monetare ose morale, në vazhdimësinë e jetës të një personi tjetër mund të sigurojnë jetën e këtij personi, vetëm me miratimin me shkrim të këtij të fundit.

2. Kontrata e sigurimit duhet të përmbajë:

2.1. emrat dhe adresat e palëve;

2.2. objektin e kontratës;

2.3. afatin e kontratës;

2.4. rrezikun e mbuluar dhe përjashtimet apo kufizimet e tjera të mbulimit;

2.5. mënyrën dhe rastet e rinovimit, ndryshimit të kontratës;

2.6. mënyrën e anulimit të pjesshëm apo në tërësi të kontratës, mënyrat e llogaritjes dhe pagesës së vlerës së përfituar nga anulimi;

2.7. mënyrat e shkëputjes së plotë apo të pjesshme të kontratës;

2.8. detyrimet e palëve dhe pasojat juridike të mospërmbushjes së tyre;

2.9. mënyrën dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit, si dhe pasojat e mospagimit apo pagimit të pasaktë nga ana e siguroesit;

- 2.10. shuma e sigurimit, mënyra e vlerësimit të saj, si dhe kushtet e pagesës;
 - 2.11. primin e sigurimit dhe mënyrën e llogaritjes së tij;
 - 2.12. kushtet e pagesës së primit dhe pasojat e mospagimit apo pagimit të pasaktë;
 - 2.13. në rastin e nënshkrimit të kontratës nga ndërmjetësuesi, kontrata duhet të përmbajë: emrin, adresën dhe të dhëna të licencës së ndërmjetësuesit;
 - 2.14. datën dhe vendin e nënshkrimit të kontratës;
 - 2.15. detyrimet e të siguruarit në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar dhe barra e tij e provës;
 - 2.16. rregulla për kapitalizmin e anuiteteve në rastin e sigurimit të sëmundjeve, aksidenteve dhe palëve të treta, nëse ato shoqërohen me pagesa anuitetesh;
 - 2.17. rregullat e zgjidhjes jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe procedurat e ankesës.
3. Kontratës së sigurimit mund t'i shtohen edhe kushte të veçanta, që lidhen me çështje specifike, të cilat nuk bien në kundërshtim me parimet e përmendura në këtë nen.
 4. Kushtet e përgjithshme publikohen në faqen e internetit të sigurvearit.
 5. Kushtet e përgjithshme të pranuar nga i siguruari, janë pjesë integrale e kontratës së sigurimit. Në rast të mospërputhjes së kushteve të veçanta të kontratës së sigurimit me kushtet e përgjithshme, dispozitat e kushteve të veçanta, të cilat janë të përcaktuara në kontratë, do të mbizotërojnë.
 6. Sigurveari detyrohet të informojë klientët për kushtet e përgjithshme të sigurimit, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit. Pyetësorit të hartuar nga sigurveari i bashkëngjiten edhe kushtet e përgjithshme.
 7. Çdo ndryshim apo zëvendësim i kushteve të përgjithshme ose hartim i ri i tyre, gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit është i vlefshëm dhe i detyrueshëm për të siguruarin, vetëm nëse për atë ndryshim ose zëvendësim të kushteve të përgjithshme të kontratës, i siguruari njoftohet paraprakisht dhe për të cilat ka dhënë miratimin me shkrim.
 8. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit duhet të jenë të shkruara qartë dhe lehtësisht të kuptueshme.
 9. Kushtet e kontratës së sigurimit, nuk duhet të jenë në kundërshtim me dispozitat e legjislativës në fuqi, praktikat në fushën e sigurimeve dhe parimet e ndershmërisë dhe mirëbesimit. Mbulimi i përcaktuar në kontratën e sigurimit, duhet të shprehet në mënyrë të qartë dhe të saktë, me qëllim që të parandalohet çorientimi dhe mashtrimi, si dhe të mos shkelen të drejtat dhe përfitimet e të siguruarit. Përveç rrezikut të mbuluar, kontrata e sigurimit duhet të shprehë qartë edhe rreziqet e përjashtuara.

Neni 47**Kontrata e sigurimit të jetës**

1. Kontrata e sigurimit të jetës duhet të jetë në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.
2. Procedurat dhe çështjet teknike për kontratën e sigurimit të jetës, përcaktohen në rregullore të miratuara nga BQK-ja.

Neni 48**Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim dhe pagesa e dëmshpërblimit**

1. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar, siguruuesi është i detyruar t'i japë të siguarit dëmshpërblimin deri në shumën e siguruar.
2. Siguruuesi trajton çdo kërkesë për dëmshpërblim, si dhe kryen pagesën në masën e duhur dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratën e sigurimit.
3. Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim nga ana e siguruuesit, përfshin edhe vlerësimin e dëmeve nga vetë siguruuesi.
4. Kërkesat për dëmshpërblim trajtohen nga siguruuesi në kohë, në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe transparente.
5. Siguruuesi krijon një sistem të brendshëm për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, si dhe harton dhe miraton procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave.
6. Siguruuesi nuk është i detyruar të paguajë shumën, e cila tejkalon kufirin e shumës së sigurimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga palët në kontratë.

Neni 49**Parimet e përgjithshme të detyrimit për informim**

1. Siguruuesi dhe ndërmjetësuesit duhet të informojnë të siguarin përpara nënshkrimit të kontratës në lidhje me subjektin e sigurimit, mbulimin dhe çështje të tjera. Detyrimi për informim fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës të vlefshmërisë së kontratës.
2. Për informatat nga paragrafi 1 i këtij neni siguruuesi informon me shkrim personin që ka nënshkruar kontratën e sigurimit. Ai garanton që informacioni i komunikuar palëve të jetë i mjaftueshëm.
3. Siguruuesi para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, duke u mbështetur në parimin e mirëbesimit, ndihmon klientin për të kuptuar aspektet teknike të mbulimit të sigurimit dhe elementet e tjera të kontratës së sigurimit, nëpërmjet dhënies së informacionit me gojë dhe me shkrim, duke mos vepruar në mënyrë mashtruese dhe çorientuese.
4. Siguruuesi para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës informon klientin për çdo konflikt interesi që mund të ketë me një palë tjetër, duke përfshirë të gjitha lidhjet ekonomike dhe juridike, të cilat ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të siguruuesit ndaj klientit.

5. Të gjitha detyrimet e siguruesit para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës zbatohen edhe për ndërmjetësuesit.

6. Siguruesi përmbush detyrimin për informim edhe ndaj personave të tjerë, që përfitojnë nga kontrata e sigurimit, në rast se kërkohet nga këta persona.

Neni 50

Detyrimi për informim përpara nënshkrimit të kontratës

1. Siguruesi dhe ndërmjetësuesit detyrohen t'i japin me shkrim çdo klienti përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, të gjithë informacionin e nevojshëm, në lidhje me llojin përkatës të sigurimit. Ky informacion duhet të përmbajë:

- 1.1. emrin e siguruesit, si dhe adresën e selisë qendrore të siguruesit;
- 1.2. adresën e selisë qendrore të degës, nëpërmjet së cilës bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;
- 1.3. procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për trajtimin e tyre;
- 1.4. rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara si dhe mundësitë për ndryshimin e kontratës në përputhje me kushtet e përgjithshme;
- 1.5. afatet dhe mënyrat e zgjidhjes dhe përfundimit të kontratës;
- 1.6. metodat e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mos pagesës së primit, si dhe masat e primit që i korrespondojnë mbulimit bazë dhe shtesë;
- 1.7. kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit dhe shumës së sigurimit;
- 1.8. metodat e llogaritjes dhe shpërndarjes të bonuseve, nëse ka;
- 1.9. procedurat jashtë gjyqësore, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimit në gjykatë;
- 1.10. kushtet për zgjidhjen e njëanshme të kontratës;
- 1.11. të dhëna të përgjithshme për obligimet tatimore dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.

2. Përjashtimisht nga përcaktimi i paragrafit 1. të këtij neni, informacioni në fjalë mund të jepet me gojë nëse kërkohet nga klienti, nëse ky i fundit kërkon mbulim të menjëhershëm. Në këtë rast menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, siguruesi i jep klientit edhe informacionin me shkrim. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit, kushteve apo anekseve të saj, nënkupton rënien dakord me informacionin e dhënë me gojë dhe pranimin e kushteve të saj.

Neni 51**Informacioni i detyrueshëm gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës**

1. Siguruesi dhe ndërmjetësuesit do të informojnë të siguarin për çdo ndryshim të legjislacionit të sigurimeve, likuidimit, bashkimit apo mbylljes së siguruesit në çdo lloj mënyre, revokimit të licencës për një klasë të caktuar apo të gjitha klasat e sigurimit, si dhe për çdo ndryshim apo ngjarje tjetër, e cila ndikon në të drejtat dhe detyrimet e të siguarit, brenda dhjetë (10) ditësh kalendarike nga data e ndodhjes së ngjarjes.
2. Siguruesi dhe ndërmjetësuesi do të përmbushin detyrimin për informim, gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, nëpërmjet faqes zyrtare, postës, faksit, postës elektronike apo mënyrave tjera të komunikimit të pranueshme për BQK-në.
3. Detyrimi për informim mund të kryhet përmes telefonit, nëse biseda telefonike regjistrohet nga një mjet magnetik apo digjital, në mënyrë që siguruesi të mund ta vërtetojë këtë gjë.

Neni 52**Kontrata e bashkësigurimit**

1. Përmes një kontrate bashkësigurimi, dy apo më shumë sigurues bashkësigurojnë rreziqet nga llojet e sigurimit, për të cilat ka licencë nga BQK-ja.
2. Siguruesit shpërndajnë ndërmjet tyre përgjegjësitë e ndërmarra nëpërmjet një kontrate sigurimi, të nënshkruar nga ata.
3. Palët në një kontratë bashkësigurimi, duhet të përcaktojnë:
 - 3.1. siguruesin kryesor;
 - 3.2. pjesën përkatëse, për të cilat siguruesit marrin përsipër përgjegjësitë;
 - 3.3. shpërndarjen e primeve të sigurimit;
 - 3.4. kushtet e përgjithshme të zbatueshme.
4. Çdo marrëdhënie me të siguarin sipas kontratës së sigurimit, kryhet nga siguruesi kryesor, përveçse kur është përcaktuar ndryshe. Siguruesi kryesor është përgjegjës për kontratën në emër dhe për llogari të të gjithë bashkësiguruesve.
5. Siguruesi kryesor, informon të siguarin për rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, në raste kur këto rrethana nuk janë të shprehura në kontratën e sigurimit.
6. Pasi i siguruari ka marrë njoftimin sipas paragrafit 5. të këtij neni, çdo bashkësigurues është përgjegjës për pjesën e tij, në përputhje me masën e përgjegjësive të marra përsipër, përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata e sigurimit.
7. BQK-ja mund të miratojë rregulla të veçanta, në lidhje me kontratën e bashkësigurimit.

KAPITULLI IX KUJDESI DHE MBROJTJA E KLIENTIT

Neni 53 Informimi i publikut

1. Siguruesi merr të gjitha masat teknike dhe administrative për të krijuar infrastrukturën e teknologjisë informative, në përputhje me kërkesat nga BQK-ja, për informimin e të siguruarit apo personave të tjerë të interesuar për sa i përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve.

2. Siguruesi përgatit faqe interneti me format lehtësisht të lexueshëm dhe që do të përmbajë së paku informacionet në vijim:

2.1. informacione të përgjithshme rreth siguruesit, aksionarëve dhe strukturës administrative, kapitalit të siguruesit;

2.2. klasat e sigurimit, shërbimet e sigurimit dhe produktet e ofruara për ato klasa;

2.3. informacione për kushtet e veçanta, rreziqet dhe mbulimet që nuk ofrohen rregullisht për një produkt sigurimi, por që mund të përfshihen si shtesë në dispozitat e kushteve të veçanta;

2.4. informacione për të drejtat dhe detyrimet e të siguruarve dhe palëve të tjera, si dhe për procedurën që duhet ndjekur në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguar;

2.5. informacionin për provizionet e zbatueshme;

2.6. adresa, posta elektronike, numri i telefonit dhe faksit të të gjitha njësive të siguruesit, përfshirë edhe atë të selisë qendrore të saj;

2.7. procedurën për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim;

2.8. formularët elektronikë që i lejojnë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, të bëjnë kërkesa për informacion dhe dëmshpërblim nëpërmjet internetit;

2.9. statistika dhe informacione të tjera të rëndësishme;

2.10. pasqyrat financiare më të fundit të audituara së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm.

3. Siguruesi krijon infrastrukturën e teknologjisë informative që t'i mundësojë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, në mënyrë të përditësuar përmes internetit, informacionin që lidhet me kontratën e sigurimit.

4. BQK-ja mund të përcaktoj edhe të dhëna tjera që duhet të publikohen sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.

5. BQK-ja mund t'i publikojë në faqen zyrtare të saj të dhënat nga ky nen dhe të dhënat e tjera shtesë sipas vlerësimit të saj.

Neni 54 **E drejta për ankesë**

1. Nëse i siguruari gjykon se siguruesi nuk i përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit, ai mund të paraqesë një ankesë pranë siguruesit.

2. Siguruesi i përgjigjet çdo ankese të dorëzuar me shkrim apo në formë elektronike nga i siguruari apo persona të tjerë të interesuar dhe jep çdo informacion të kërkuar, që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

3. Siguruesi duhet të krijojë një sistem të brendshëm për trajtimin e ankesave dhe procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre ankesave.

4. Ankesat e të siguruarve trajtohen në mënyrë të paanshme dhe brenda afatit të përcaktuar me akte nënligjore.

5. I siguruari ka të drejtë t'i drejtohet BQK-së për çdo pakënaqësi të trajtimit të ankesës së tij nga siguruesi. I siguruari mund t'i drejtohet BQK-së edhe për ankesa ndaj ndërmjetësuesve të sigurimeve apo vlerësuesve të dëmeve apo profesionistëve tjerë të sigurimeve.

6. BQK-ja kur e vlerëson të nevojshme i kthen për rishqyrtim siguruesit çështjen e ankimuar. BQK-ja brenda kompetencave të saj mbikëqyrëse, vlerëson nëse siguruesi zbaton praktikata më të mira, rregullat profesionale, kërkesat e ligjit dhe kushtet e kontratës së sigurimit.

7. Procedurat dhe shqyrtimi i ankimimit në BQK përcaktohen me rregullore.

8. BQK-ja do të mbajë statistika për ankesat që pranon nga policëmbajtësit.

Neni 55 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Siguruesi harton dhe miraton procedura të brendshme të përshtatshme, që do të zbatohen nga siguruesi në rastet kur palët bien dakord që mosmarrëveshjet ndërmjet të siguruarve apo klientëve me siguruesin apo ndërmjetësuesit të zgjidhen në mënyrë jashtë gjyqësore.

2. Siguruesi publikon informacionin për rregullat e zgjidhjes jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve, si pjesë e kushteve të kontratës së sigurimit.

3. Në rastet e lindjes së mosmarrëveshjes për shkak të paqartësive të krijuara nga gjuha e përdorur në hartimin e kushteve të kontratës së sigurimit të hartuara nga siguruesi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet duke interpretuar kushtet në favor të të siguarit.

4. BQK-ja mund të kërkojë krijimin e një forumi arbitrazhi për zgjidhjen e kontesteve midis të siguarit dhe siguruesit dhe procedurat e këtij arbitrazhi mund t'i përcaktojë me rregullore.

KAPITULLI X KONFIDENCIALITETI PROFESIONAL

Neni 56 Konfidencialiteti

Siguruesi dhe ndërmjetësuesit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me të siguruarit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 57 Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Aksionarët, bordi i drejtorëve, menaxherët e lartë, të punësuarit dhe çdo punonjës i siguruesit, të cilët gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre përdorin të dhënat konfidenciale, nuk duhet t'ia japë ato palëve të treta, t'i përdorë kundër interesave të siguruesit dhe klientëve të saj apo të mundësojë përdorimin e tyre nga palë të treta.

2. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk zbatohet nëse:

- 2.1. i siguruari e miraton shprehimisht me shkrim nxjerrjen e tyre;
- 2.2. të dhënat kërkohen në procese gjyqësore dhe një kërkesë e tillë është bërë me shkrim nga gjykata kompetente;
- 2.3. të dhënat kërkohen në procese hetimore nga organi i Prokurorisë;
- 2.4. në rastet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- 2.5. informacioni kërkohet nga BQK-ja me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të saj;
- 2.6. informacioni kërkohet nga organet tatimore;
- 2.7. informacioni jepet sipas dispozitave të Ligjit "për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia".

3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe pasi personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni largohen nga siguruesi me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2. të këtij neni.

4. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për ndërmjetësuesit në sigurime dhe profesionistëve tjerë në sigurime.

5. BQK-ja dhe organet tjera të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, i përdorin informacionet konfidenciale, vetëm për qëllimet për të cilat janë dhënë ato informacione.

Neni 58**Mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale**

1. Siguruesi mbledh, ruan dhe përdor të dhënat personale, të cilat janë të nevojshme për nënshkrimin e policave të sigurimit dhe për zgjidhjen e ankesave, që rrjedhin nga çdo çështje sigurimi sipas këtij ligji, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Siguruesi krijon, ruan dhe mirëmban bazat e të dhënave:

2.1. për personat e siguruar;

2.2. për dëmet e ndodhura;

2.3. për vlerësimin e mbulimit të sigurimit dhe shumat e dëmshpërblimit.

KAPITULLI XI**MENAXHIMI I RREZIKUT****Neni 59****Rregullat e menaxhimit të rrezikut**

1. Siguruesi është i detyruar që ta mbajë nivelin e kapitalit në vëllimin përkatës në raport me rreziqet e ndërmarra.

2. Siguruesi është i detyruar të bëjë afarizëm në atë mënyrë që rreziqet të cilave u ekspozohet në punë të veçanta, përkatësisht në të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të cilat i ushtron, të mos i tejkalojnë vlerat ose kufijtë e paraparë me këtë ligj, si edhe me dispozitat e miratuara në bazë të tij.

3. Siguruesi është i detyruar që të bëjë afarizëm në atë mënyrë që të jetë e aftë që t'i përmbushë me kohë detyrimet e arritura (parimi i likuiditetit), në atë mënyrë që të jetë vazhdimisht e aftë për t'i përmbushur të gjitha detyrimet (parimi i solventitetit – aftësisë për pagesë).

4. Siguruesi harton dhe miraton politika e procedura të qarta dhe të hollësishme për identifikimin, matjen, monitorimin dhe parandalimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 60**Kapitali i siguruesit**

1. Çdo sigurues ose risigurues obligohet të mirëmbaj nivelin minimal të kapitalit, e që duhet të jetë adekuat për llojet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të tij sigurues dhe në përputhje me rreziqet ndaj të cilëve iu është ekspozuar. Llogaritja e kapitalit të siguruesit, përcaktohet me rregullore të veçantë të kërkuara nga BQK-ja.

2. BQK-ja përcakton nivelin minimal të kapitalit për siguruesit, dhe metodat e llogaritjes, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë këtu parimet e nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimit.

3. BQK-ja mund të urdhërojë siguruesin që të rritë kapitalin e tij në nivelin e kërkuar, duke marrë për bazë numrin e klasave të sigurimit dhe ekspozimin ndaj rrezikut nga siguruesi. Për çdo klasë shtesë të sigurimit, kompanisë mund t'i kërkohej të shtojë kapital shtesë, ashtu siç do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga BQK-ja.

Neni 61

Llogaritja e kapitalit

1. Çdo sigurues mban një nivel të kapitalit që është adekuat për llojet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të tij sigurues dhe në përputhje me rreziqet ndaj të cilëve është ekspozuar.

2. Me qëllim të zbatimit të rregullave për menaxhimin e rrezikut, kapitali i siguruesit (më tutje "kapitali") llogaritet duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe kontabilitetit, përfshirë këtu parimet e nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimit.

3. Siguruesi gjatë gjithë aktivitetit sigurues, duhet të mirëmbajë nivelin minimal të kapitalit të kërkuar, margjinës minimale të aftësisë paguesesolvensës dhe të likuiditetit.

4. Aftësia paguese-solvenca përcaktohet si totali i asetëve, duke zbritur asetet e papranueshme dhe totalin e detyrimeve, përjashtuar kapitalin minimal.

5. BQK-ja me rregullore të veçantë, përcakton mënyrën e llogaritjes së ekuitetit, margjinës minimale të solvensës dhe treguesve të tjerë të likuiditetit.

Neni 62

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese

1. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesit, që i kryen punët e sigurimeve në grupin e sigurimeve jo jetë, është i detyrueshëm të jetë i njëjtë me kufirin e solventitetit të përlogaritur në bazë të raportit të primeve, përkatësisht të dëmeve, cilado që është më e lartë.

2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese (solvensës) për siguruesit që ushtrojnë aktivitet sigurimi gjatë gjithë aktivitetit sigurues, nuk duhet të jetë më i ultë se niveli minimal i kërkuar për aftësi paguese të siguruesit, e vendosur nga BQK-ja.

3. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesit që ushtron veprimtari në klasat e sigurimit jetë, mund të llogaritet siç përcaktohet me rregullore të veçantë, të lëshuar nga BQK-ja.

4. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesit, që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës, llogaritet si shuma totale e rezultateve të përfituara nga metodat e përdorura. Metodatat dhe mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për siguruesin, që ushtron veprimtari në klasat e jetës, përcaktohen nga BQK-ja me rregullore.

Neni 63

Plani i rimëkëmbjes financiare

1. Në rast të rrezikimit të të drejtave të siguruarve, BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi, plan financiar me masa të propozuara deri në maksimum tri (3) vite, për rimëkëmbje financiare, e që

duhet të përmbajë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

1.1. vlerësimin e shpenzimeve të menaxhmentit, përkatësisht të shpenzimeve të menaxhimit, si edhe krahasimin me shpenzimet e tërësishme dhe me provizionet;

1.2. vlerësimin e hollësishtëm të të hyrave dhe të dalave nga punët e drejtpërdrejta të sigurimeve;

1.3. pasqyrat financiare të projektuara;

1.4. vlerësimin e mjeteve të nevojshme financiare për arritjen e baraspeshës së kapitalit dhe të mbulesës së të gjitha detyrimeve të siguresit;

1.5. politikën e risigurimit.

2. BQK-ja mund të kërkojë kapital më të madh sesa ai i paraparë me dispozita të këtij Ligji, në qoftë se e vlerëson se për shkak të pozitës së dobësuar financiare të siguresit, janë rrezikuar të drejtat e të siguruarve. Lartësia e kapitalit caktohet në bazë të planit financiar, bashkë me masat e propozuara.

3. BQK-ja mund të kërkojë zvogëlimin e vlerës së pasurisë së siguresit, e cila përfshihet në përlogaritje të kapitalit të siguresit, në qoftë se ka ndodhur ndryshimi i vlerës së tregut të asaj pasurie.

4. BQK-ja mund të kërkojë përshtatjen e përlogaritjes së kufirit të solventitetit të siguresit për shumën e risigurimit, në qoftë se të hyrat ose cilësia e kontratës së risigurimit në krahasim me vitin e mëparshëm afarist ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme ose nëse kontratat e risigurimit nuk e bëjnë të mundshëm bartjen e balancuar të rrezikut.

Neni 64

Menaxhimi i likuiditetit

1. Siguruesi menaxhon burimet financiare dhe investimet e tij në mënyrë të tillë, që të sigurojë fonde adekuate në çdo kohë për përmbushjen e përgjegjësive kur u vjen afati i pagesës.

2. Siguruesi, me qëllim mbrojtjen ndaj rrezikut të likuiditetit, miraton dhe zbaton politika për menaxhimin e likuiditetit, që përfshijnë:

2.1. planifikimin e fluksit monetar;

2.2. monitorim sistematik të likuiditetit;

2.3. zbatimin e masave të përshtatshme për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.

3. Siguruesi llogarit shumat e fondeve të likuiditetit, në minimum në baza tremujore.

4. Siguruesi llogarit normat e likuiditetit dhe nivelin minimal të tyre mbi bazën e metodave të përcaktuara me rregullore nga BQK-ja.

Neni 65 **Raportimi në BQK**

1. Siguruesi llogarit dhe dërgon periodikisht:

1.1. raportet financiare: Pasqyrën e pozicionit financiar, llogarinë e fitimit dhe humbjes, raportin e riskut, raportin mbi rrjedhën e parasë dhe raportin për ndryshimet në kapital-ekuitet;

1.2. nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;

1.3. provizionet teknike të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar;

1.4. vlerën dhe llojin e investimeve, të cilat nuk financohen nga primi i rrezikut;

1.5. vlerën e aktiveve në mbulim të provizioneve teknike;

1.6. llojet, shpërndarjen, përputhjen e aktiveve me detyrimet dhe vendndodhjen e aktiveve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike;

1.7. programin dhe kontratat e risigurimit;

1.8. normat e likuiditetit;

1.9. rreziqet e marra për çdo klasë sigurimi;

1.10. të dhëna statistikore për sigurimin;

1.11. planin e biznesit për vitin e ardhshëm;

1.12. informacione të tjera të kërkuara nga BQK-ja.

2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese në baza tremujore dhe vjetore, llogaritet sipas rregulloreve të BQK-së.

3. BQK-ja përcakton me rregullore të veçantë metodën, mënyrën, përmbajtjen, formën dhe afatet e raportimeve.

Neni 66 **Shpërndarja e dividendes**

1. Siguruesi nuk mund të shpërndajë kurrfarë dividende për aksionaret, pa aprovimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.

2. BQK-ja mund ta refuzojë kërkesën për shpërndarje të dividendës, nëse sipas vlerësimit të saj, pagesa e dividendës do ta vështirësonte gjendjen financiare të siguruesit.

Neni 67

Provizionet teknike

1. Siguruesi krijon dhe mban gjatë gjithë aktivitetit sigurues, nivel të mjaftueshëm të provizioneve teknike, për të mbuluar përgjegjësitë e nënshkruara dhe humbjet nga rreziqet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Provizionet teknike llogariten bruto, pa zbritur risigurimet e ceduara, në përputhje me parimet aktuariale dhe rregulloret e miratuara nga BQK-ja.

2. Siguruesi krijon llojet e mëposhtme të provizioneve teknike:

- 2.1. provizionet për bruto primin e pafituar;
- 2.2. provizionet për rreziqet e paskaduara;
- 2.3. provizione për mbrojtjen e rrezikut ndaj investimeve;
- 2.4. provizione tjera teknike.

3. Provizionet për rezervat për bruto dëmet si në vijim:

- 3.1. rezerva për dëmet e rregulluara, por jo të paguara;
- 3.2. të njohura por jo të rregulluara;
- 3.3. të ndodhura por jo të raportuara;
- 3.4. rezerva tjera për dëme.

4. BQK-ja mund të miratojë ose refuzojë mjaftueshmërinë e provizioneve teknike. Nëse BQK-ja vlerëson se provizionet teknike nuk janë të mjaftueshme, urdhëron siguruesin të mbajë dhe të pasqyrojë provizionet teknike në vlerën që e kërkon BQK-ja.

5. Në rastet e bashkësigurimit, provizionet teknike krijohen nga palët sipas kontratës së bashkësigurimit, në përputhje me pjesën përkatëse të përgjegjësive të marra përsipër nga ana e tyre.

6. Bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provizioneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre, përcaktohen me rregullore të miratuar nga BQK-ja.

Neni 68

Provizionet teknike të dëmeve

1. Provizionet teknike të dëmeve krijohen në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga siguruesi përmes kontratave të sigurimit, kur ngjarja e siguruar ndodh para përfundimit të periudhës financiare, pavarësisht nëse ngjarja është raportuar apo jo, duke përfshirë çdo shpenzim të pagueshëm nga siguruesi të përcaktuar në kontratën e sigurimit.

2. Provizionet teknike të dëmeve gjithashtu përfshijnë edhe përgjegjësitë për dëmet, të cilat

kanë ndodhur por nuk janë raportuar si dhe shpenzimet për rregullimin e dëmeve.

Neni 69

Asetet në mbulim të provizioneve teknike

1. Siguruesi duhet të mbajë aktivë të mjaftueshme në para të gatshme ose në ekuivalentet e parasë së gatshme, në mbulim të provizioneve teknike sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Asetet në mbulim të provizioneve teknike, janë aktivet e siguruesit, të cilat shërbejnë për mbulimin e përgjegjësive të ardhshme, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe që mbulojnë humbjet si pasojë e rreziqeve që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së siguruesit, për të cilat kjo e fundit detyrohet të krijojë provizione teknike.
3. Vlera e aseteve në mbulim të provizioneve teknike në çdo kohë duhet të jetë në pajtim me kërkesat e BQK-së.

KAPITULLI XII

MBAJTJA E RAPORTEVE FINANCIARE DHE RAPORTIMI FINANCIAR

Neni 70

Mbajtja e kontabilitetit dhe dokumentacionit

1. Siguruesi mban në mënyrë të vazhdueshme librin kryesor të kontabilitetit, bilancin vërtetues, përgatit regjistrimet kontabël, vlerëson aktivet dhe detyrimet, përgatit pasqyrat financiare, mban dokumentacionin e veprimtarisë së siguruesit si dhe të dhëna tjera mbi menaxhimin ose veprimtarinë siguroese në një zyrë brenda territorit të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të mundësojë në çdo kohë kontrollin për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit në përputhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut, legjislationit në fuqi, të metodologjive të mbikëqyrjes dhe rregullave të hartuara nga BQK-ja si dhe standardet profesionale.
2. Siguruesi duhet të garantojë që informacioni, dokumentacioni dhe të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë gjendjen e vërtetë financiare të tij.
3. BQK-ja mund të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të këtij neni.

Neni 71

Raportimi

1. Siguruesi, përgatit pasqyrat financiare dhe raporte të tjera të detajuara mbi veprimtarinë e tij, si dhe ia paraqet ato BQK-së në përputhje me formën, mënyrën, përmbajtjen dhe afatet kohore, të përcaktuara me rregullore dhe udhëzime të BQK-së.
2. Siguruesi përgatit pasqyra financiare në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar si dhe rregulloreve të BQK-së.
3. Siguruesit dorëzojnë në BQK pasqyrat financiare tre mujore dhe vjetore, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendrike nga data e përfundimit të periudhës, për të cilin përgatiten pasqyrat financiare.

4. Risiguruesi i licencuar nga BQK-ja i paraqet në BQK pasqyrat financiare dhe raportet e tjera mbi veprimtarinë e saj, të paaudituar jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike pas mbarimit të vitit, për të cilin përgatiten raportet.

5. Siguruesi përgatit dhe paraqet raporte financiare dhe raporte të tjera të veprimtarisë së saj për periudha kohore më të shkurtra se një (1) vit kalendarik në pajtim me kërkesat e BQK-së.

Neni 72

Raporti dhe opinioni i aktuarit

Siguruesi, brenda afatit që e përcakton BQK-ja me rregullore, është i obliguar që të dorëzoj në BQK raportin e aktuarit, së bashku me opinionin e tij, që tregon se llogaritjet e provizioneve teknike janë të mjaftueshme dhe në pajtueshmëri me standardet aktuariale dhe me këtë ligj.

Neni 73

Transaksionet financiare

1. Të gjitha transaksionet financiare, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga siguruesit, kryhen nëpërmjet institucioneve financiare, të licencuara nga BQK-ja.

2. Paragrafi 1 i këtij neni aplikohet edhe për transaksionet financiare të ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe trajtuesve të dëmeve, që janë licencuar si persona juridik.

3. Nëse kërkohet nga BQK-ja, siguruesi dhe personat e përmendur në paragrafin 2. të këtij neni, dorëzojnë në BQK listën me emrin e bankave dhe llogaritë bankare.

KAPITULLI XIII

Neni 74

Detyrimi për risigurim

1. Siguruesi është i detyruar të risigurojë te një risigurues, pjesën e rreziqeve të siguruara, të cilat në bazë të tabelave të mbulimit maksimal, tejkalojnë mbulimin maksimal.

2. Siguruesi risiguron përgjegjësitë e saj te një risigurues, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e përcaktuara nga BQK-ja.

3. Asnjë sigurues nuk mund të mbajë rrezik më të lartë se dhjetë përqind (10%) e kapitalit themeltar, për një rast të siguruar. Mbulimi maksimal i siguruesit nuk mund të tejkaloj dhjetë përqind (10%) e kapitalit themeltar, të përcaktuar me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

4. BQK-ja përcakton me rregullore mbulimin maksimal për rrezik për çdo klasë të veprimtarisë dhe për rreziqe agregate dhe të akumuluar, deri në vlerën dhjetë përqind (10%) të parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni.

5. Siguruesi mund të risigurojë përgjegjësitë e kontraktuara me të siguruarin, te një risigurues vendas apo të huaj.

6. Siguruesi, i cili risiguron përgjegjësitë e kontraktuara është përgjegjës vetëm ndaj të siguruarit. I siguruari nuk ka të drejtë të ndërmarrë drejtpërdrejt veprime juridike ndaj risiguruesit.

Neni 75

Programi i planifikuar i risigurimit

1. Siguruesi, për çdo vit financiar, harton dhe zbaton programin e nevojave për risigurime, në vartësi të strukturës së portofolit të sigurimit, si dhe përcakton marrëveshjet e risigurimit, sipas të cilave ajo duhet të sigurojë tejkalimin e mbulimit të rreziqeve.

2. Programi i planifikuar i risigurimeve, së paku duhet të përmbaj:

2.1. llogaritjen e rreziqeve të mbajtura për çdo klasë sigurimi;

2.2. tabelën e mbulimeve maksimale, të hartuar në bazë të llogaritjeve të përmendura në nënparagrafin 2.1 të këtij paragrafi;

2.3. procedurat, bazat dhe kriteret e përcaktimit të probabilitetit më të lartë të humbjeve që mund të rrjedhin nga ndodhja e një ngjarje të vetme, nga një rrezik i caktuar i marrë përsipër.

3. Siguruesi dorëzon në BQK programin e sigurimeve jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para mbylljes së vitit financiar.

4. BQK-ja pasi shqyrton programin e risigurimeve, mund ta refuzojë atë nëse programi nuk i përmbush kriteret e caktuara me këtë ligj apo ndonjë kriter të përcaktuar nga BQK-ja.

5. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të këtij kapitulli.

KAPITULLI XIV

KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMI I BRENDSHËM

Neni 76

Sistemi i kontrollit të brendshëm

1. Siguruesi krijon sistemet e kontrolleve të brendshme për monitorimin dhe zbatimin e të gjitha politikave dhe procedurave të brendshme, për vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së siguruesit, si dhe për monitorimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Objektivat e sistemeve të kontrolleve të brendshme janë: identifikimi i llojeve të rreziqeve, ndaj të cilave siguruesi është i ekspozuar, si dhe matja, menaxhimi dhe monitorimi i nivelit të tyre.

3. Siguruesi harton politika në lidhje me menaxhimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm, auditimin e brendshëm dhe kur është e nevojshme edhe politika për delegimin e funksioneve. Bordi i drejtorëve të siguruesit duhet të garantojë një mbikëqyrje të rregullt për zbatimin e politikave, strategjive dhe sistemeve të menaxhimit të rrezikut.

4. Politikat e hartuara të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni rishikohen të paktën një herë në vit.

5. Veprimtaria e kontrollit të brendshëm është pjesë përbërëse e veprimtarisë së përditshme të siguruesit dhe përfshin kontrollin e çdo njësie organizative të saj, verifikime fizike të aktiveve dhe informimin, monitorimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me legjisllacionin në fuqi, kontrole të sistemit të verifikimit dhe bashkërendimit të informacioneve financiare, si dhe rishqyrtim periodik të efektivitetit të kontrolleve të mëparshme.

6. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore procedurat dhe parimet minimale në lidhje me kontrollin e brendshëm të siguruesve.

Neni 77

Auditimi i brendshëm

1. Siguruesi duhet të krijojë njësinë e auditimit të brendshëm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm, e cila ka për detyrë të ushtrojë një metodë të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, menaxhimit e rrezikut dhe kontrolleve të siguruesit.

2. Auditimi i brendshëm krijohet si një njësi e pavarur dhe objektive për të dhënë opinion të specializuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimtarinë e siguruesit.

3. Auditimi i brendshëm kryen auditimin e veprimtarisë së siguruesit në përputhje me parimet profesionale dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe praktikat e mira në fushën e auditimit të brendshëm.

4. Auditimi i brendshëm duhet të ketë qasje në të gjitha njësitë funksionale dhe mbështetëse të siguruesit si dhe në të gjitha funksionet që delegohen nga siguruesi.

5. Auditimit të brendshëm duhet t'i sigurohet autoritet i mjaftueshëm për të raportuar gjetjet dhe rekomandimet e tij te bordi i drejtorëve, pasi janë shqyrtuar paraprakisht nga komiteti i auditimit, si dhe për të ndjekur në bashkëpunim me menaxherët e lartë të siguruesit zbatueshmërinë e tyre.

6. BQK-ja mund të miratojë rregullore për detyrat dhe kriteret e punonjësve të auditimit të brendshëm, programin e auditimit të brendshëm dhe raportimet e veprimtarisë së tij.

KAPITULLI XV AUDITIMI I JASHTËM

Neni 78

Auditori i jashtëm

1. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve të siguruesit emëron auditorin e jashtëm, i cili duhet të jetë person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari auditimi në Republikën e Kosovës.

2. Siguruesi duhet të kërkojë miratimin paraprak nga BQK-ja për emërimin e auditorit të jashtëm,

si dhe për çdo ndryshim të tij.

3. Siguruesi njofton BQK-në në rast kur kërkon zëvendësimin e auditorit të jashtëm dhe vetë auditori i jashtëm njofton BQK-në me rastin e dorëheqjes.

4. Auditori i jashtëm, i miratuar nga BQK-ja, mund të kryej auditimin në të njëjtin sigurues, për një periudhë jo më të gjatë se pesë (5) vite pandërprerë dhe mund të marrë pjesë në auditimin e të njëjtit sigurues përsëri, pas kalimit të afatit kohor prej të paktën dy (2) vitesh.

Neni 79

Raporti i auditorit të jashtëm

1. Auditori i jashtëm i dorëzon raportin e auditimit bordit të drejtorëve dhe komitetit të auditimit të siguruesit.

2. Auditori i jashtëm duhet të jep opinionin e tij për pasqyrat financiare, në pajtim me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe rregullativës ligjore në fuqi.

3. Auditori i jashtëm raporton menjëherë në BQK, çdo fakt që lidhet me siguruesin, për të cilin auditori i jashtëm është vënë në dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij, në lidhje me:

3.1. shkeljet e ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilat përcaktojnë kushtet, në bazë të të cilave i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtari sigurimi;

3.2. mashtrim ose përvetësim, vjedhje, pastrim parash apo financim të terrorizmit;

3.3. shkelje të rëndësishme të rregullave të brendshme të siguruesit;

3.4. ndryshim të rëndësishëm të rezultatit financiar, të paraqitur në llogaritë vjetore të paaudituar;

3.5. fakte dhe rrethana të tjera shtesë, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi veprimtarinë e mëtejshme të siguruesit;

3.6. çdo transaksion të siguruesit me palë të lidhura, që përbën rrezik për likuiditetin dhe për rregullat e menaxhimit të rrezikut.

4. Raporti i auditimit, përmban opinionin për pasqyrat financiare, i cili shoqërohet nga raporti i aktuarit të siguruesit, i cili jep opinion për mjaftueshmërinë e provizioneve teknike në pasqyrën e pozitës financiare të siguruesit sipas këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore, duke u bazuar në teknikat e duhura aktuariale.

5. Raportimi, informimi dhe dhënia e çdo fakti sipas paragrafëve 3. dhe 4., të këtij neni, nga ana e auditorit të jashtëm, nuk përbën shkelje të kufizimeve për dhënie të informacionit, dhe auditori i jashtëm lirohet nga çfarëdo përgjegjësie lidhur me informacionin e dhënë në BQK.

6. BQK-ja mund t'i kërkojë auditorit të jashtëm shpjegime shtesë për auditimin e kryer dhe raportin e auditimit, si dhe çdo informacion tjetër që BQK-ja e gjykon të nevojshëm në funksion të ushtrimit të autorizimeve mbikëqyrëse.

7. Siguruesi dorëzon në BQK një kopje fizike dhe elektronike të raportit vjetor të audituar dhe letrën e menaxhmentit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendrike nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës.

8. BQK-ja mund të kërkojë nga auditori i jashtëm ekzaminimin e letrave të punës.

Neni 80

Ribërja e auditimit të jashtëm

1. Nëse raporti i auditorit të jashtëm nuk kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji apo standardeve ndërkombëtare të raportimit dhe auditimit, si dhe nuk pasqyron situatën e vërtetë dhe të drejtë financiare të siguruesit, atëherë BQK-ja nuk e pranon raportin në fjalë dhe ka të drejtë të kërkojë riauditimin nga një tjetër auditor i jashtëm, me shpenzimet e siguruesit.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, BQK-ja ka të drejtë të ndalojë auditorin e jashtëm të auditojë siguruesit e licencuar në Kosovë, për një periudhë deri në tre (3) vjet.

Neni 81

Publikimi i pasqyrave financiare të audituara

1. Siguruesi përgatit dhe publikon raportin vjetor i cili përmban pasqyrat financiare të audituara dhe të shoqëruara nga opinioni i auditorit të jashtëm, në faqen e saj të internetit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendrike nga data e miratimit të tij nga mbledhja e bordit drejtues të kompanisë, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga përfundimi i vitit financiar të audituar.

2. BQK-ja nxjerr rregullore për përmbajtjen e detajuar të publikimit të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të këtij kapitulli.

KAPITULLI XVI

MBIKËQYRJA NGA BQK-JA

Neni 82

Mbikëqyrja e siguruesve

1. BQK-ja mbikëqyr veprimtarinë e siguruesve, me qëllim për të kontrolluar, vlerësuar dhe shqyrtuar përmbushjen nga siguruesit, të rregullave të menaxhimit të rrezikut, rregullave, udhëzimeve dhe metodologjive, në zbatim të këtij ligji, si dhe legjislacionin e zbatueshëm në fushën e sigurimeve.

2. BQK-ja mund të kërkojë informata nga personat juridikë të lidhur me një sigurues, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së siguruesit.

3. Nëse për mbikëqyrjen e personave të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni është kompetent një autoritet tjetër mbikëqyrës, atëherë informatat për veprimtarinë e personit juridik, të lidhur me siguruesin mund të kërkojnë nga autoriteti mbikëqyrës.

4. BQK-ja mund të bashkëpunojë me autoritetet tjera mbikëqyrëse, si dhe me institucione tjera ndërkombëtare me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së siguruesve.

Neni 83

Metoda e mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e siguruesve dhe personave tjerë subjekteve të mbikëqyrjes sipas këtij ligji, ushtrohet nga BQK-ja nëpërmjet: monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raporteve dhe njoftimeve të dorëzuara nga siguruesit dhe personave tjerë, subjekte të mbikëqyrjes të cilët sipas legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin për të raportuar në BQK apo për ta njoftuar atë, për çdo fakt ose rrethanë të veçantë (mbikëqyrja off-site) dhe kontrollit në vend të veprimtarisë së siguruesit dhe personave tjerë subjekte të mbikëqyrjes (mbikëqyrja on site).

2. BQK-ja ushtron funksionet e saj mbikëqyrëse, bazuar në metodologjinë me fokus rreziku.

3. BQK-ja mund të hartojë metodologji dhe manuale në zbatim të këtij neni.

Neni 84

Raportimi në BQK

1. Siguruesi, raporton në BQK, si në vijim:

1.1. regjistrimin e çdo ndryshimi të të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Bizneseve;

1.2. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve bordit të drejtorëve;

1.3. emërimin dhe shkarkimin e stafit menaxhues, aktuarit dhe auditorit të jashtëm;

1.4. fillimin e planifikuar të veprimtarisë, zhvendosjen, mbylljen apo ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë së zyrave apo çdo ndryshim në llojet e veprimtarisë së ushtruar nga dega;

1.5. ndryshimet e rëndësishme në strukturën e kapitalit të përcaktuara me këtë ligj;

1.6. ndërprerjen e veprimtarive në një klasë të caktuar të sigurimit;

1.7. kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të reja të sigurimit, si dhe ndryshimet e atyre ekzistuese;

1.8. kontratat e risigurimit të nënshkuara me risiguruesit;

1.9. planet e biznesit sipas afateve të përcaktuara nga BQK-ja;

1.10. pasqyrat financiare: pasqyrën e pozicionit financiar, llogarinë e fitimit dhe humbjes, raportin për ndryshimet në kapital (ekuitet), raportin mbi rrjedhën e parasë, raportin e riskut, si dhe raportin dhe mendimin e aktuarit;

1.11. kontratat me ndërmjetësuesit e sigurimeve, vlerësuesit e dëmeve dhe auditorit të

jashtëm, nëse kërkohet nga BQK-ja.

2. Nëse kërkohet nga BQK-ja, siguruesi e njofton atë, për bazën teknike të përdorur për llogaritjen e primit, përshtirë tarifën dhe komisionet.

3. Bordi i drejtorëve ose menaxhmenti i lartë i siguruesit, njofton menjëherë BQK-në nëse:

3.1. rrezikohet likuiditeti ose aftësia paguese e siguruesit;

3.2. për aktivitetet mashtruese dhe joligjore, për të cilat janë në dijeni;

3.3. gjendja financiare e siguruesit përkeqësohet në atë masë, sa që ajo nuk është në gjendje të mbajë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të përcaktuar me këtë ligj apo me akte nënligjore në zbatim të tij, që përcaktojnë mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për tre (3) muajt e ardhshëm.

4. BQK-ja mund të kërkojë nga personat e mbikëqyrur, çdo informacion dhe dokumentacion që lidhet me veprimtarinë e tyre. Personat e mbikëqyrur janë të detyruar t'i japin BQK-së çdo dokument dhe informacion të kërkuar.

5. BQK-ja përcakton me rregullore, në mënyrë të detajuar, përmbajtjen e raportit të përmendur në këtë nen, mënyrën, formën e afatit kohor të raportimit dhe njoftimit.

Neni 85

Ekzaminimi i veprimtarisë së siguruesve dhe subjekteve tjera të mbikëqyrura

1. Ekzaminimi i veprimtarisë së siguruesve dhe subjekteve tjera të mbikëqyrura, kryhet nga BQK-ja.

2. BQK-ja, për qëllime të kryerjes së ekzaminimeve të veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, mund të autorizojë edhe persona të tjerë të specializuar, që nuk janë punonjës të BQK-së.

3. Gjatë kryerjes së ekzaminimit të veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, personat e përmendur në paragrafin 2. të këtij neni, kanë të njëjtat kompetenca me punonjësit e BQK-së.

Neni 86

Kryerja e ekzaminimit

1. Subjekti i mbikëqyrur duhet t'i lejojë zyrtarët e BQK-së, që për qëllime të kryerjes së ekzaminimeve, të kenë qasje të plotë në çdo dokument elektronik apo fizik.

2. Me kërkesë të zyrtarëve të BQK-së, bordi i drejtorëve, menaxhmenti dhe zyrtarët e subjektit të mbikëqyrur, vënë në dispozicion të tyre, raportet dhe çdo informacion tjetër për të gjitha çështjet e ushtrimit të veprimtarisë që lidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes.

3. Zyrtarët e BQK-së mund të kërkojnë nga organet kompetente, t'iu ofrojnë shënime për veprimtarinë e personave juridikë të lidhur me subjektin e mbikëqyrur, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të pasur një informacion më të hollësishëm në lidhje me veprimtarinë subjektit të mbikëqyrur.

4. Çdo subjekt i mbikëqyrur nga BQK-ja, duhet të pranojë dhe bashkëpunojë plotësisht me zyrtarët e BQK-së dhe personat e caktuar nga BQK-ja. Askush nuk ka të drejtë të përpiqet të provokojë, pengojë, vonojë, ndalojë, frikësojë ose të ushtrojë ndikim të pajustificuar ndaj një zyrtari të BQK-së ose personave të caktuar prej saj.

Neni 87

Programi i ekzaminimit të veprimtarisë të subjektit të mbikëqyrur

1. BQK-ja e njofton subjektin e mbikëqyrur për ekzaminim jo më pak se dhjetë (10) ditë kalendarike përpara fillimit të ekzaminimit.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse BQK-ja e gjykon të nevojshme, mund të fillojë ekzaminimin pa njoftim paraprak.
3. Njoftimi për ekzaminim duhet të përmbajë fushëveprimin e ekzaminimit.
4. BQK-ja, gjatë ekzaminimit mund të zgjerojë programin e ekzaminimit dhe të zgjasë periudhën kohore të planifikuar.
5. BQK-ja mund të kryejë ekzaminim edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të zbatimit të Ligjit, sipas programeve të përbashkëta të inspektimit të miratuara ndërmjet tyre.

Neni 88

Kushtet për kryerjen e ekzaminimit

Subjekti i mbikëqyrur krijon për zyrtarët e BQK-së, ambient pune të veçantë e të përshtatshëm për kryerjen e ekzaminimit, pa ndërhyrjen apo praninë e personave të tjerë.

Neni 89

Raporti i ekzaminimit

1. Pas përfundimit të ekzaminimit, BQK-ja përgatit draft raportin e ekzaminimit, një kopje të të cilit ia dërgon subjektit të ekzaminuar për komente.
2. Subjektet e ekzaminuara, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike pas pranimit të draft-raportit të ekzaminimit, duhet t'i kthejnë komentet apo vërejtjet e tyre në BQK.
3. Pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga subjekti i ekzaminuar, BQK-ja përgatit raportin final, një kopje të të cilit ia dërgon subjektit të ekzaminuar.

Neni 90

Mbikëqyrja e grupit të siguruesve

1. BQK-ja shkëmben informacione lidhur me anëtarët e grupit, si dhe mund të marr pjesë në mbledhjet e caktuara me qëllim të mbikëqyrjes së siguruesve në grup.
2. Mbikëqyrja e një grupi të siguruesve përfshinë:

- 2.1. mbledhjen dhe verifikimin e informatave që janë të nevojshme për qëllimet e mbikëqyrjes;
- 2.2. mbikëqyrjen e transaksioneve ndër-grupore, të paraparë me nenin 91 të këtij ligji;
- 2.3. mbikëqyrjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të grupit, të paraparë me ligj dhe rregullore;
- 2.4. ndërmarrjen e masave korigjuese, në rast të rrezikimit të siguruesit në një grup, që rezulton nga aktivitetet ose gjendja financiare e ndonjë siguruesi tjetër në grupin e siguruesve.

Neni 91

Transaksionet ndërgrupore

1. Siguruesit dhe subjektet tjera të licencuara sipas këtij ligji dhe që janë pjesë e grupeve të sigurimeve, raportojnë në BQK në baza vjetore të gjitha transaksionet ndërgrupore.
2. BQK-ja ushtron mbikëqyrje mbi transaksionet e rëndësishme (që raportohen në pasqyrën vjetore), ndërmjet siguruesve në grupin e siguruesve apo një personi, që ka pjesëmarrje prej njëzet përqind (20%) apo më shumë në ndonjë sigurues në grupin e siguruesve.
3. Transaksionet e rëndësishme sipas paragrafit 2 të këtij neni iu referohen në veçanti:
 - 3.1. kredive;
 - 3.2. garancioneve dhe transaksioneve jashtë bilancit të gjendjes;
 - 3.3. operacioneve të risigurimit;
 - 3.4. investimeve;
 - 3.5. marrëveshjeve për ndarjen e borxheve;
 - 3.6. blerjeve dhe/apo shitjeve të aseteve;
 - 3.7. qirave të pronës së paluajtshme;
 - 3.8. kontratave për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve;
 - 3.9. transferit të aseteve.
4. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të këtij neni.

Neni 92

Raportimi në BQK dhe dhënia e informacionit lidhur me grupin e sigurimit

1. Siguruesi njofton rregullisht BQK-në për çdo fakt ose rrethanë që mund të jetë e rëndësishme për të përcaktuar nëse ai është pjesë e një grupi sigurimi.
2. Siguruesi në një grup sigurimi, përgatit një aneks të veçantë të raportit vjetor duke dhënë të gjitha të dhënat mbi kompanitë amë dhe të kontrolluara të grupit të sigurimit.
3. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore përmbajtjen e detajuar të raporteve, afatet kohore dhe mënyrën e raportimit lidhur me grupin e sigurimit.

KAPITULLI XVII

ADMINISTRIMI I PËRKOHSHËM

Neni 93

Vendimi për administrimin e përkohshëm

1. BQK-ja me qëllim që të rikthejë siguruesin në një situatë financiare të qëndrueshme, mund të marrë vendim për administrimin e përkohshëm të siguruesit, në rastet e mëposhtme:

1.1. nëse siguruesi i urdhëruar të marrë masat në përputhje me këtë ligj, nuk ka filluar zbatimin e këtyre masave ose nuk i ka zbatuar këto masa brenda afatit kohor të përcaktuar nga BQK-ja;

1.2. siguruesi, pavarësisht zbatimit të masave të përcaktuara me urdhër të BQK-së, nuk ka arritur ende nivelin e kërkuar të likuiditetit, dhe aftësisë paguese sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe rregulloreve në zbatim të tij;

1.3. veprimtaria e mëtejshme e siguruesit rrezikon likuiditetin, aftësinë paguese të saj ose sigurinë e të siguruarit.

2. BQK-ja e përcakton periudhën kohore për administrimin e përkohshëm.

Neni 94

Administratori i përkohshëm

BQK-ja me vendim, emëron një administrator të përkohshëm dhe përcakton kompetencat e tij, në pajtim me këtë ligj.

Neni 95

Pasojat juridike të administrimit të përkohshëm

1. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të administrimit të përkohshëm, të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat menaxhmentit të lartë, bordit të drejtorëve dhe asamblesë së përgjithshme të aksionarëve do të përfundojnë, me përjashtim të kompetencave të përcaktuara në paragrafin 2. të nenit 98 të këtij ligji.

2. BQK-ja i jep administratorit të përkohshëm udhëzime të detyrueshme për t'u zbatuar në lidhje me riorganizimin dhe administrimin e siguruesit. BQK-ja shkarkon administratorin e përkohshëm nëse ai nuk vepron në përputhje me udhëzimet në fjalë.

Neni 96

Kompetencat e administratorit të përkohshëm

1. Anëtarët e bordit të drejtorëve të siguruesit që kanë ushtruar atë detyrë deri në datën e vendimit të administrimit të përkohshëm detyrohen të vënë në dispozicion të administratorit të përkohshëm të gjitha të dhënat e biznesit dhe dokumentet e tjera të siguruesit, duke përfshirë edhe një raport të gjendjes financiare, si dhe të përgatitin një raport të detajuar për detyrat, të cilat i dorëzohen administratorit të përkohshëm.

2. Me kërkesë të administratorit të përkohshëm, personat e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, i vënë atij në dispozicion të gjitha shpjegimet dhe raportet shtesë mbi veprimtarinë e siguruesit.

3. Administratori i përkohshëm ka të drejtë të shkarkojë çdo person që pengon punën e tij dhe që nuk jep informacionin e kërkuar.

Neni 97

Raportimi i administratorit të përkohshëm

Administratori i përkohshëm raporton periodikisht në BQK, për ecurinë e administrimit të përkohshëm sipas formave dhe afateve të përcaktuara nga BQK-ja.

Neni 98

Rritja e kapitalit minimal për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare

1. BQK-ja, duke u bazuar në raportet e administratorit të përkohshëm, mund të kërkojë nga administratori i përkohshëm të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të siguruesit dhe të propozojë rritjen e kapitalit, nëse gjykon se kjo është e nevojshme.

2. Administratori i përkohshëm thërret mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për të vendosur rritjen e kapitalit, brenda afatit të përcaktuar nga BQK-ja. Administratori i përkohshëm e njofton asamblesën e përgjithshme të aksionarëve, se në rast se refuzohet rritja e kapitalit, sipas paragrafit 1. të këtij neni, siguruesi do të kalojë në likuidim, sipas dispozitave për likuidimin të këtij ligji.

Neni 99

Vlerësimi i rezultateve të administrimit të përkohshëm

1. BQK-ja duhet të vlerësojë rezultatet e administrimit të përkohshëm të paktën një herë në tre (3) muaj.

2. Nëse BQK-ja vlerëson se gjatë administrimit të përkohshëm gjendja financiare e siguruesit është përmirësuar në atë masë sa siguruesi ka arritur nivelin e kërkuar të likuiditetit dhe aftësisë pagueuse dhe është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohë, merr vendim në bazë të të cilit administratorit të përkohshëm i kërkohet që brenda afatit të caktuar, të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të siguruesit.

3. Në rastin e përmendur në paragrafin 2. të këtij neni, mbledhja e asamblesë së përgjithshme emëron anëtarët e bordit të drejtorëve, të cilët rimarrin kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me këtë ligj.

4. Detyra e administratorit të përkohshëm përfundon me vendim të BQK-së dhe pasi BQK-ja të miratoj anëtarët e rinj të bordit të siguruesit.

5. BQK-ja mund të vendos zgjatjen e mandatit të administratorit të përkohshëm, nëse gjykon se gjendja financiare e siguruesit nuk është përmirësuar në atë masë sa të arrijë nivelin e kërkuar të likuiditetit dhe aftësisë paguese ose të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohë. Kjo zgjatje mund të bëhet vetëm nëse sipas vlerësimit të BQK-së, siguruesi nuk ndodhet në kushtet për fillimin e procedurave të likuidimit dhe siguruesi ka mundësi të arrijë nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

6. Nëse BQK-ja vlerëson se siguruesi nuk mund të arrijë nivelin e kërkuar të likuiditetit dhe aftësisë paguese, atëherë i revokon licencën dhe merr vendim për hapjen e procedurave të likuidimit.

7. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të këtij kapitulli.

KAPITULLI XVIII LIKUIDIMI I SIGURUESVE

Neni 100 Inicimi i likuidimit

1. Pas revokimit të licencës, BQK-ja emëron menjëherë një likuidator për të marrë në kontroll të plotë siguruesin. Kjo procedurë njihet si Likuidim.

2. Pavarësisht nga çfarëdo lloj ligji për likuidim që mund të jetë në fuqi në Kosovë, dispozitat e këtij ligji për likuidimin, zbatohen për likuidimin e siguruesve.

Neni 101 Likuidimi vullnetar

1. Nëse aksionarët e siguruesit dëshirojnë që vullnetarisht ta likuidojnë siguruesin, në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare apo çfarëdo ligji tjetër në fuqi, ata duhet t'i paraqesin BQK-së një kërkesë për miratimin e likuidimit vullnetar, shoqëruar me të dhëna të tilla që BQK-ja mund t'i përcaktojë.

2. BQK-ja mund të bëjë rishikimin e të gjitha të dhënave dhe informatave të siguruesit dhe nëse vlerëson se interesat e policëmbajtësve dhe kreditorëve tjerë të siguruesit do të mbrohen në mënyrë të mjaftueshme, atëherë mund të miratojë likuidimin vullnetar sipas ligjit në fuqi ose të vendosë për zbatimin e dispozitave të këtij ligji lidhur me likuidimin dhe të emërojë likuidatorin.

Neni 102

Likuidatori

1. Likuidatori mund të jetë personi, i cili i plotëson kushtet e parashtruara nga BQK-ja.
2. BQK-ja mundet për ndonjë arsye ta largojë likuidatorin. Në kushtet e pagesës së likuidatorit, mund të përfshihet nxitja për likuidimin e shpejtë të pasurisë dhe shpërndarja e përfitimeve, poseduesve të policave dhe kreditorëve si dhe mund të përfshihen ndëshkimet për mosrealizimin e objektivave të tilla.
3. Pagesa e likuidatorit dhe e ekspertëve të angazhuar nga likuidatori, kompensimi i shpenzimeve të tyre si dhe shpenzimet e BQK-së për zbatimin e këtij ligji lidhur me siguruesin, do të bëhen nga fondet e siguruesit. Pagesat për likuidatorin bëhen në mënyrë të vazhdueshme. Çfarëdo detyrimi ndaj likuidatorit duhet të paguhet nga fitimi i shitjeve të pasurisë së siguruesit në nivelin e përparësisë së pagesave të përcaktuara me dispozitat e këtij ligji për likuidimin.
4. Të gjitha shpenzimet operative që i bën likuidatori, paraprakisht duhet të aprovohen nga BQK-ja.

Neni 103

Njoftimi dhe regjistrimi i Likuidimit

1. Likuidatori brenda dy (2) ditësh pune pas emërimit, dërgon njoftimin në çdo zyrë të siguruesit. Njoftimi duhet të saktësojë edhe kohën e marrjes së përgjegjësive nga likuidatori. Po ashtu, njoftimi duhet të përmbajë:
 - 1.1. autorizimet e personave të angazhuar lidhur me përgjegjësinë financiare të siguruesit janë anuluar;
 - 1.2. personat të cilët më parë kanë pasur autorizime për të dhënë udhëzime në emër të siguruesit, lidhur me pagesat apo transferin e pasurisë së siguruesit apo për të administruar pasurinë e siguruesit nuk i kanë më ato autorizime;
 - 1.3. licenca e siguruesit është anuluar; dhe
 - 1.4. dëshmia e dëmeve dhe pretendimet kundër siguruesit duhet t'i dorëzohen likuidatorit brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas publikimit të fundit në gazetë.
2. Likuidatori duhet të publikojë njoftimin, me të cilin saktësohen veprimet e ndërmarra sipas këtij neni në një ose në më shumë gazeta me qarkullim të gjerë në Kosovë. Publikimi duhet të bëhet jo më rrallë se një herë në javë dhe do të zgjasë një muaj . BQK-ja do të shikojë dhe miratojë përmbajtjen e njoftimit.

Neni 104

Detyrat dhe përgjegjësitë e likuidatorit dhe efektet e likuidimit

1. Funksionet kryesore të likuidatorit janë që të administrojë siguruesin në likuidim, ta likuidojë pasurinë e tyre, të paguajë dëmet që u janë shkaktuar poseduesve të policave dhe kreditorëve.

2. Likuidatori i ka të gjitha autorizimet e bordit të drejtorëve dhe aksionarëve të siguruesit në fjalë.
3. Në varësi të qëllimit primar për plotësimin maksimal të detyrimeve të siguruesit ndaj poseduesve të policave dhe kreditorëve, likuidatori e shpejton shitjen e pasurisë së siguruesit dhe pagesat për poseduesit e policave.
4. Likuidatori mund të ndërmarrë çfarëdo veprimi në drejtim të likuidimit të siguruesit.
5. Likuidatori nuk mund të lëshojë polica të reja apo të zgjas afatin e policave ekzistuese.
6. Likuidatori, me miratim me shkrim të BQK-së, mund të marrë hua të garantuar me aktivën e siguruesit ose të pa garantuar.
7. Likuidatori mund të ndalojë ose kufizojë pagesën e çfarëdo detyrimi, të punësojë dhe largojë nga puna punonjësit, menaxherët apo këshilltarët, të ekzekutojë çfarëdo instrumenti në emër të siguruesit apo të iniciojë ose të mbrojë e të ndërmarrë në emër të siguruesit çfarëdo veprimi apo procedure ligjore.
8. Likuidatori ka autorizime të pakufizuara për të hyrë dhe për t'i kontrolluar zyrat, librat e llogarive dhe shënimet tjera, si dhe pasurinë dhe detyrimet tjera të siguruesit.
9. Me kërkesën e likuidatorit, zyrtari i zbatimit të ligjit ose zyrtarët tjerë do ta ndihmojnë likuidatorin që të hyjë në objektet e siguruesit, për t'i kontrolluar asetet e tij.
10. Likuidatori ka të drejtë të paraqesë padi dhe të mbrohet kundër padive në gjykata të rregullta dhe në procedura arbitrazhi, në emër të siguruesit në likuidim.
11. Likuidatori ka të drejta dhe privilegje të njëjta dhe i nënshtrohet detyrimeve, ndëshkimeve, kushteve dhe kufizimeve të njëjta që zbatohen për bordin e drejtorëve apo të punësuarve të tjerë, të një siguruesi të licencuar sipas këtij ligji.
12. Të drejtat e bordit të drejtorëve dhe të aksionarëve të siguruesit suspendohen gjatë likuidimit. Likuidatori i mban disa apo të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve dhe punonjësit me kompensim të arsyeshëm që nevojitet për të administruar likuidimin dhe për t'i kryer funksionet, posaçërisht të caktuara me shkrim nga likuidatori.
13. Likuidatori mund t'i largojë nga puna të gjithë punonjësit e siguruesit dhe ata mund të mos marrin kurrfarë kompensimi për shkak të këtij largimi.
14. Likuidatori e siguron pasurinë e siguruesit dhe kërkon mbrojtjen e saj nga vjedhja apo nga ndonjë veprim tjetër i papranueshëm duke ndërmarrë veprime që veçmas përfshijnë:
 - 14.1. ndërrimin e çelësave dhe kufizimin e përdorimit të tyre të hyrjeve të jashtme të zyrave të siguruesve dhe të zyrave të brendshme, ku ka mjete financiare, të dhëna apo pajisje që do t'i mundësonin ndonjë individ të ketë qasje joligjore në mjetet financiare;
 - 14.2. ndërrimin apo krijimin e kodeve në kompjuterët e siguruesit dhe t'i lejohej qasje vetëm një numri të caktuar të punonjësve e të besueshëm;

14.3. lëshimin e kartelave të reja të identifikimit me fotografi për hyrje të të punësuarve të autorizuar në lokalet e siguruesve dhe kontrollit të hyrjes të personave të tjerë në këto lokale;

14.4. anulimin e autorizimeve për personat me përgjegjësi financiare të siguruesit dhe lëshuarjen e autorizimeve të reja dhe njoftimi i palëve të treta për këtë;

14.5. informimin e poseduesve të policave, agjentëve, brokerëve, risiguruesve, zyrove relevante për tatim, bankave dhe bizneseve që kanë raporte afariste me siguruesin, se personat të cilët më parë kanë qenë të autorizuar për të dhënë këshilla në emër të siguruesve lidhur me udhëheqjen e pasurisë dhe llogarive, nuk kanë më autorizime të tilla dhe se vetëm likuidatori dhe individët e autorizuar nga ai kanë një autorizim të tillë, dhe;

14.6. pezullimin e pagesave në përgjithësi me shpërndarje të gjerë dhe të pagesave të çfarëdo lloji për bordin e drejtorëve dhe aksionarët me kusht, që bordit të drejtorëve t'u paguhet rroga bazë për shërbimet e bëra sipas cilësisë së tyre si anëtar të bordit të drejtorëve.

15. Likuidatori do të përgatis një bilanc të ri të gjendjes të siguruesit në likuidim, bazuar në përcaktimin e vlerës së asetëve në likuidim me zvogëlim ekuivalent me vlerën e detyrimeve të siguruesit në likuidim. Detyrimet do të konsiderohen si të pritura për pagesë dhe kamata do të pushojë së rrituri qysh nga dita e emërimit të likuidatorit.

16. Brenda një (1) muaji pas marrjes në posedim të siguruesit, likuidatori bën regjistrimin e të gjitha pasurive të sigurimeve dhe ia dërgon një kopje të atij regjistrimi BQK-së, e cila do t'ia vë në dispozicion një kopje publikut për vlerësim.

17. Pas marrjes në posedim të siguruesit nga Likuidatori:

17.1. çdo afat, çdo çështje statutare, kontraktuese apo tjetër; kërkesat apo të drejtat e siguruesit që skadojnë apo shuhen, do të zgjaten edhe për gjashtë (6) muaj nga dita e skadimit apo e shuarjes;

17.2. çdo konfiskim apo kamatë sigurie që ka ndodhur gjashtë (6) muajt e fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit, anulohet dhe asnjë konfiskim apo interes sigurie, përveç atij të krijuar nga likuidatori gjatë zbatimit të këtij neni, nuk mund të konfiskohet nga pasuria e siguruesit nën likuidim, përderisa të zgjasë likuidimi; dhe

17.3. shuhen të drejtat e aksionarëve, përveç të drejtës për pranimin e pasurisë nëse mbetet diç pas kryerjes së kënaqshme të kërkesave që kanë përparësi ndaj aksionarëve dhe e drejta për të pranuar çdo pagesë neto të marrë nga të ardhurat e siguruesit dhe kryesisht e gjithë pasuria e tij, nëse likuidatori vërteton se siguruesi ka pasur vlerë neto pozitive në kohën e shitjes.

18. Kërkesat ndaj siguruesit duhet të dorëzohen te likuidatori, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas shpalljes së fundit në gazetë. Kërkesa që nuk dorëzohet brenda këtij afati kohor mund të merren në konsiderim vetëm pas zgjidhjes së kënaqshme të të gjitha kërkesave të dorëzuara me kohë, dhe vetëm atëherë kur kërkuesi ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm, lidhur me mos dorëzimin brenda afatit të përcaktuar, përndryshe, kërkesa nuk do të paguhet.

19. Procedurat e përcaktimit të vlefshmërisë, shumës së kërkesave dhe likuidimi i pasurisë së siguruesit dhe pagesa e kërkesave, do të përcaktohet me rregullore nga ana e BQK-së.

20. Shitja e pasurisë duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe komercialisht të arsyeshme.

21. Likuidatori i raporton BQK-së për çdo muaj për mbarëvajtjen e procedurave të likuidimit, në mënyrën siç e përcakton BQK-ja.

Neni 105

Personat profesionistë

1. Likuidatori mundet të angazhojë kontabilistë, aktuarë, vlerësues, avokatë, konsultantë dhe profesionistë tjerë, vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga BQK-ja.

2. Kërkesa për miratim të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të përcaktojë në hollësi nevojën për angazhimin e tyre, kompensimin e propozuar për personat e tillë dhe një vërtetim, që dëshmon të gjitha faktet materiale nëse personi ka lidhje me siguruesin. Personi i angazhuar nuk duhet të ketë lidhje me likuidatorin dhe siguruesin. Para se t'i bëhet çfarëdo pagese një personi të tillë, likuidatori duhet të marrë miratimin me shkrim të BQK-së për shumën e një pagese të tillë.

Neni 106

Shmangia e transfereve para likuidimit

1. Likuidatori mund të ngrisë padi në Gjykatë për të anuluar një transaksion të bazuar në një dokument të falsifikuar apo mashtrues, që siguruesi e ka lëshuar në dëm të poseduesve të policave apo kreditorëve gjatë pesë (5) viteve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit.

2. Likuidatori mund të ngritë padi në Gjykatë për të anuluar transaksionet e mëposhtme, të cilat ndikojnë në pasurinë e siguruesit ose për t'i kthyer nga palët e treta, transferet e siguruesit si në vijim:

2.1. transferet dhuruese për çdo person që ka lidhje me siguruesin që janë bërë gjatë pesë (5) viteve të fundit, para hyrjes në fuqi të likuidimit;

2.2. transferet dhuruese palëve të treta brenda pesë (5) viteve të fundit, para hyrjes në fuqi të likuidimit;

2.3. transaksionet, në të cilat dëmshpërblimi i dhënë nga siguruesi ka tejkaluar dukshëm vlerësimin real, që është kryer gjatë tri (3) viteve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit;

2.4. çdo veprim i bërë me qëllimin të të gjitha palëve të implikuara, që të fshehet pasuria nga poseduesit e policave apo nga kreditorët ose të dobësohen të drejtat e tyre gjatë pesë (5) viteve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit;

2.5. krijimi i së drejtës së pengmarrjes, ose ndonjë huaje në pasurinë e siguruesit pa miratimin paraprak të BQK-së; dhe

2.6. nëse gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit,

siguruesi ka bërë transfere të pasurisë ose parasë së gatshme në emër të një borxhi për ndonjë kreditor, dhe ky transfer ka ndikuar që ai kreditor të përfitoj më shumë sesa që do të përfitonte në rast se pagesa do të ishte bërë pas likuidimit, me kusht që anulimi nga ky nën paragraf të mos zbatohet në transferet e kryera për policëmbajtësit që rrjedhin nga policat e tyre të sigurimit.

3. Likudatori mund të ngritë padi në gjykatë për të anuluar transaksionet me personat e lidhur me siguruesin që janë bërë brenda një viti para hyrjes në fuqi të likuidimit, nëse transaksionet e tilla kanë qenë të dëmshme për interesat e pronarëve të policave të sigurimit dhe të kreditorëve të tjerë. Veprimin për anulimin e transaksioneve (transfereve) të tilla, mund ta bëjë likudatori brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të likuidimit.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të parashtruara në këtë nen, likudatori nuk mund të anulojë një pagesë apo transfer të siguruesit, nëse është bërë në rrjedha të zakonshme të afarizmit, apo nëse kjo ka qenë pjesë e këmbimit të njëkohshëm për një vlerë të arsyeshme ekuivalente, ose në atë masë që pas transferit marrësi i ka ofruar një kredi të pasiguarur siguruesit, e cila nuk është përmbushur nga siguruesi, deri në datën e hyrjes në fuqi të likuidimit.

5. Likudatori mund të kthejë pasurinë ose vlerën e pasurisë së transferuar të siguruesit nga një përfitues i transferit fillestar, vetëm nëse pranuesi i transferit fillestar nuk e ka paguar vlerën reale të pronës dhe e ka ditur se transferi fillestar ka mundur të pezullohej sipas dispozitave të këtij ligji.

6. Qiradhënësi i zyrave të siguruesit dhe/apo kryesit e shërbimeve publike, siç është për shembull rryma, gasi natyral, uji, shërbimi telefonik nuk mund t'ia ndërpresin shërbimet e tilla siguruesit vetëm për shkak të likuidimit apo për shkak se siguruesi nuk i ka paguar ato shërbime para likuidimit. Pavarësisht nga ky kufizim, një qiradhënës i tillë apo kryes i shërbimeve publike, mund të kërkojë që likudatori të deponojë një depozitë sigurie në ndonjë bankë, si kusht për qiradhënësin dhe kompaninë e shërbimeve publike për të vazhduar detyrimin e kryerjes së shërbimeve publike, gjatë procedurave të likuidimit. Shuma maksimale e një depoziti të tillë, nuk mund të jetë më e madhe se çmimi i shërbimeve të kryera për siguruesin gjatë muajit të fundit, para se të fillojë likuidimi.

Neni 107

Përparësitë në pagesën e kërkesave

1. Në çdo likuidim të pasurisë së siguruesit, kërkesat e lejuara dhe të siguruara paguhen nga fitimi i pasurisë garantuese ose përndryshe pasuria e garantuesit i dërgohet kreditorit të siguruesit. Çfarëdo shume e një kërkesë të lejuar e të siguruar që mbetet pasi pengu të jetë shpenzuar, trajtohet si kërkesë e siguruar.

2. Kërkesat tjera të lejuara paguhen për të gjitha borxhet tjera sipas përparësive të përshkuara më poshtë:

2.1. shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të shkaktuara nga likudatori dhe BQK-ja, duke përfshirë pagesat e profesionisteve gjatë zbatimit të dispozitave të këtij Ligji për likuidimin;

2.2. pagat e arsyeshme dhe beneficinet e sigurimit social për punonjësit jo menaxherial të siguruesit në likuidim;

2.3. këkesat e ligjshme të papaguara për policat e sigurimit;

2.4. tatimet dhe detyrimet e mbetura brenda një (1) viti para fillimit të likuidimit; dhe

2.5. kreditorët tjerë dhe shumat e pasiguruara të kërkesave të siguruara.

3. Përbushja e kërkesave që i takojnë një klase të mëvonshme, me prioritet më të ulët, mund të iniciohet vetëm pas përbushjes complete dhe të plotë të kërkesave të klasës paraprake me prioritet më të lartë. Nëse shuma në dispozicion për pagesë, për çfarëdo klase të kërkesave është e pamjaftueshme për të bërë pagesën e plotë, kërkuesat e tilla zvogëlohen në përmasa proporcionale.

4. Çfarëdo përfitimesh që mbesin pas pagimit të kërkesave të poseduesve të policave të sigurimit dhe kreditorëve të tjerë, ndahen mes aksionarëve ose pronarëve të siguresit, në përputhje me të drejtat e tyre.

Neni 108

Dispozitat tjera të likuidimit

1. Punonjësve dhe personave profesionalë të emëruar për të përfaqësuar ose ndihmuar likuidatorin ose BQK-në lidhur me likuidimin, nuk mund t'u paguhen shuma më të mëdha se ato që u paguhen punonjësve ose agjentëve të siguresve për shërbimet e ngjashme në Kosovë, përveç nëse BQK-ja mund të lejojë pagesa më të larta, nëse vlerëson se pagesa më të larta nevojiten për rekrutimin dhe mbajtjen e kuadrit të nevojshëm dhe profesionist.

2. BQK-ja ka autorizime që t'i kompenzojë Likuidatorët dhe agjentët e tyre për veprimet e tyre, në kushtet të cilat BQK-ja i konsideron të përshtatshme.

Neni 109

Raportimi përfundimtar në BQK

1. Pasi të jetë bërë shitja e pasurisë së siguresit, likuidatori i paraqet një raport përmbledhës BQK-së, i cili duhet të përfshijë një bilanc të gjendjes, pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe burimeve për shfrytëzimin e fondeve gjatë kohës së likuidimit.

2. Pas miratimit të raportit përmbledhës nga BQK-ja, BQK-ja dhe likuidatori lirohen nga çfarëdo përgjegjësie tjetër në lidhje me likuidimin e siguresit.

KAPITULLI XIX

NDËRMJETËSUESIT DHE TRAJTUESIT E DËMEVE

Neni 110

Ndërmjetësuesit në sigurime

1. Ndërmjetësues në sigurime është personi fizik apo juridik i kontraktuar nga siguresi dhe i licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit të sigurimeve, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

2. Ndërmjetësimi në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi. Ndërmjetësuesit në sigurime ndahen në dy kategori, varësisht nga fakti nëse ata veprojnë kryesisht në llogari të siguruesve apo në llogari të të siguruarve:

2.1. kur ndërmjetësuesi vepron kryesisht në llogari të siguruesve, ata njihen si agjentë;

2.2. kur ndërmjetësi vepron kryesisht në llogari të të siguruarve, ata njihen si broker dhe janë të pavarur nga siguruesit, produktet e të cilëve i shet.

3. Veprimtaritë e mëposhtme nuk do të quhen ndërmjetësim në sigurime:

3.1. ofrimi i informacionit në mënyrë rastësore gjatë ushtrimit të një veprimtarie tjetër profesionale, nëse qëllimi i kësaj veprimtarie nuk është dhënia e asistencës në nënshkrimin ose zbatimin e kontratave të sigurimit;

3.2. veprimtaria e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, nëse kryhet në kushtet e punësimit;

3.3. veprimtaria e vlerësimit të dëmeve.

4. Trajtuesit e dëmeve janë persona juridik të kontraktuar nga të siguarit apo siguruesit të licencuar nga BQK-ja për të kryer aktivitete të vlerësimit të dëmeve dhe aktivitete tjera vlerësuese të sigurimeve, që kanë lidhje me sigurimet.

5. Ndërmjetësuesit e sigurimeve mund të përfaqësojnë një apo më shumë sigurues, varësisht nga kufizimet që mund t'i përcaktoj BQK-ja me rregullore.

6. Mbikëqyrja e ndërmjetësuesve në sigurime dhe profesionistëve tjerë bëhet nga BQK-ja. Dispozitat e këtij ligji për mbikëqyrjen e siguruesve, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve në sigurime dhe profesionistëve tjerë.

Neni 111

Agjenti i sigurimeve

Agjenti i sigurimeve është personi fizik, i licencuar nga BQK-ja dhe i punësuar ose kontraktuar nga siguruesi, apo shoqëria e agjentëve, që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime sipas përcaktimeve të nenit 110 paragrafi 2.1 të këtij ligji.

Neni 112

Kompania e agjentëve në sigurime

1. Kompania e agjentëve në sigurime është person juridik i licencuar nga BQK-ja dhe e kontraktuar nga një ose më shumë sigurues, që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime sipas përcaktimeve të nenit 110 paragrafi 2.1 të këtij ligji.

2. Kompania e agjentëve themelohet sipas dispozitave të Ligjit për shoqëritë tregtare, si shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

3. Kompania e agjentëve duhet ta ketë së paku një agjent të licencuar, i cili është i punësuar i kësaj kompanie të agjentëve me orar të plotë dhe me kontratë punësimi.
4. Kompania e agjentëve në emrin e vet përdor fjalët “veprimtari agjenti në sigurime” ose derivate të tyre.
5. Emri i kompanisë së agjentëve nuk duhet të përmbajë emrin e plotë apo të pjesëshëm të asnjë siguruesi apo risiguruesi që janë të licencuara nga BQK-ja.
6. BQK-ja mund të përcaktojë rregulla për qeverisjen e mirë të kompanisë së agjentëve.

Neni 113 **Brokëri në Sigurime**

Brokëri në sigurime është personi fizik, i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga një ose më shumë sigurues ose një kompani e brokerëve, që të zhvilloj aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime, sipas përcaktimeve të nenit 110 paragrafi 2.2 të këtij ligji.

Neni 114 **Kompania e brokerimit**

1. Kompania e brokerimit është person juridik i licencuar nga BQK-ja dhe e kontraktuar nga një ose më shumë sigurues, të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime, sipas përcaktimeve të nenit 110 paragrafi 2.2 të këtij ligji.
2. Kompania e brokerimit themelohet sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë tregtare, si shoqëri aksionare ose si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
3. Kompanitë e brokerimit duhet të kenë së paku një broker të licencuar, i cili është i punësuar i kësaj kompanie të brokerimit me orar të plotë dhe me kontratë punësimi.
4. Kompania e brokerimit në emrin e saj përdor fjalët “veprimtari brokerimi në sigurime/risigurime” ose derivate të kësaj fjale.
5. Emri i kompanisë së brokerimit nuk duhet të përmbajë emrin e plotë apo të pjesëshëm të asnjë siguruesi apo risiguruesi, që janë të licencuara nga BQK-ja.
6. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore për qeverisjen e mirë të kompanisë së brokerimit.

Neni 115 **Vlerësuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë të sigurimeve**

1. Vlerësuesit e dëmeve apo kompanitë e vlerësimit të dëmeve dhe profesionistët tjerë të sigurimeve, janë persona fizikë ose juridikë të licencuar nga BQK-ja dhe të kontraktuar nga të siguruarit apo siguruesit, për të kryer aktivitetet e vlerësimit të dëmeve dhe aktivitetet tjera vlerësuese apo profesionale të sigurimeve.
2. Vlerësuesit e dëmeve, kompanitë e vlerësimit të dëmeve dhe profesionistët tjerë themelohen sipas dispozitave të Ligjit për shoqëritë tregtare.

3. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të këtij neni.

Neni 116

Përgjegjësia e siguruesve dhe ndërmjetësuesve të saj

1. Siguruesi në emër të të cilit veprojnë agjentët apo kompania e agjentëve është përgjegjës i vetëm për veprimet ose mosveprimet e bëra nga agjentët apo kompanitë e agjentëve, në lidhje me të siguruarit.

2. Agjentët apo kompania e agjentëve është përgjegjëse ndaj siguruesit për humbjet e shkaktuara ndaj të siguruarve, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të shkaktuara me faj apo informacionit të pamjaftueshëm.

3. Agjentët apo kompanitë e agjentëve ushtrojnë vetëm ato veprimtari, për të cilat janë të licencuara nga BQK-ja.

4. Agjentët apo kompanitë e agjentëve nuk kanë të drejtë të autorizojnë ndonjë person tjetër të nënshkruajnë dhe lëshojnë polica të sigurimit në llogari të tij.

5. Agjentët apo kompania e agjentëve nuk mundën, që në emër dhe në llogari të tyre të mbledhin primet e sigurimit apo çfarëdo pagesash monetare nga i siguruari.

Neni 117

Mbrojtja e interesave të të siguruarve

1. Gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit duhet t'i mbrojnë interesat e të siguruarve.

2. Ndërmjetësuesit janë përgjegjës ndaj të siguruarve për humbjet që pësojnë ata, kur këto shkaktohen nga veprimet apo mosveprimet e kryera me faj ose keqinformimi i të siguruarit.

3. Ndërmjetësuesi duhet të kontrollojë përmbajtjen e kontratës së sigurimit përpara lidhjes së saj. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, ndërmjetësuesi mbron ato interesa të siguruesit, të cilat janë të detyrueshme për të siguruarin përpara dhe pas përfundimit të kontratës së sigurimit. Gjatë kryerjes së veprimeve përgatitore për nënshkrimin e kontratës së sigurimit, ndërmjetësuesi duhet të informojë siguruesin për çdo rrezik, për të cilin ka ose mund të kishte dijeni.

4. Ndërmjetësuesi duhet të informojë të siguruarin për lidhjet ekonomike dhe juridike, që mund të ketë me një sigurues të caktuar, të cilat mund të ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të ndërmjetësuesit ndaj të siguruarit.

5. Marrëdhëniet juridike dhe ekonomike, në kuptim të paragrafit 4 të këtij neni, quhen marrëveshjet e ndërmjetësuesit të përfunduara me një sigurues në bazë të të cilave një ndërmjetësues ka të drejtën e një komisioni ndërmjetësimi të veçantë ose më të lartë për klasa të caktuara të sigurimit.

Neni 118

Licencimi i ndërmjetësuesve, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve tjerë të sigurimeve

1. BQK-ja me rregullore do të përcaktojë kriteret me dokumentacionin relevant të kërkuara për licencimin e ndërmjetësuesve, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve tjerë.
2. BQK-ja licencon ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë të sigurimeve nëse plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloret në zbatim.
3. Rregullorja e BQK-së do të përcaktojë kriteret për profesionalizëm dhe përshtatshmëri si dhe kërkesat financiare, të cilat duhet të plotësohen nga ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët në sigurime.
4. Ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë të sigurimeve, gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktiviteteve të tyre, duhet të jenë në pajtim me kërkesat e këtij neni dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve tjera relevante.
5. BQK-ja do të revokojë licencën e ndërmjetësuesit, trajtuesit të dëmeve dhe profesionistëve tjerë, nëse ai:
 - 5.1. ofron informacione të rrejshme dhe të falsifikuara në aplikacionin e licencimit;
 - 5.2. është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
 - 5.3. është angazhuar në mashtrime gjatë aktivitetit të tij në fushën e sigurimeve;
 - 5.4. ka shkelur dispozitat ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - 5.5. shkeljen e kodit të etikës dhe rregullave profesionale në fushën e sigurimeve;
 - 5.6. nëse nuk i përmbush urdhrat apo udhëzimet e BQK-së brenda kohës së caktuar.
6. Licenca e ndërmjetësuesit, trajtuesit të dëmeve dhe profesionistëve tjerë përfundon nëse :
 - 6.1. nuk fillon aktivitetin e tij sigurues brenda gjashtë (6) muajve nga data e lëshimit të licencës;
 - 6.2. nëse nuk zhvillon aktivitet brenda gjashtë (6) muajve;
 - 6.3. është hapur procedura e likuidimit;
 - 6.4. ndërpret vullnetarisht aktivitetin për të cilin është licencuar.
7. BQK-ja nëse e vlerëson të nevojshme, për shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, para revokimit të licencës, mund të vendosë ta pezullojë licencën për periudhë deri në gjashtë (6)

muaj apo më shumë, nëse pezullimi lidhet me shkelje, të cilat duhet të vërtetohen nga organe tjera.

Neni 119

Sigurimi i përgjegjesisë profesionale

1. Ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë, duhet të kenë policë të sigurimit të përgjegjesisë profesionale për t'i mbuluar përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të cilat linden si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të kryera me faj.

2. BQK-ja mund të përcaktojë me rregullore apo udhëzim, lartësinë e mbulesës siguroese të sigurimit të përgjegjesisë profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 120

Veprimtaria e kompanive të agjentëve dhe kompanive të brokerimit

1. Veprimtaria e ndërmjetësuesve në sigurime mund të ushtrohet nga kompani të agjentëve dhe kompani të brokerimit, me seli në Republikën e Kosovës, të licencuara të ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi në sigurime sipas këtij ligji.

2. Kompanitë e agjentëve dhe kompanitë e brokerimit, duhet të kenë së paku një agjent, respektivisht broker të licencuar, i cili duhet të jetë i punësuar me orar të plotë te kjo kompani.

3. Kompanitë e agjentëve dhe kompanitë e brokerimit, mund të ofrojnë kontrata të sigurimeve vetëm për siguresit e licencuar nga BQK-ja.

4. Kompanitë e agjentëve dhe kompanitë e brokerimit, nuk lejohet të ndërmjetësojnë kontrata të sigurimit, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera që rregullojnë kontratat e sigurimeve.

5. Kompanitë e agjentëve dhe kompanitë e brokerimit, duhet të informojnë siguresit për lidhjet juridike dhe ekonomike, që ata mund t'i kenë me secilin sigures të veçantë dhe që mund të ndikojnë në obligimet e tyre ndaj të siguruarve.

6. Kompanitë e agjentëve dhe kompanitë e brokerimit, nuk mund të jenë aksionar të asnjë siguresi dhe anasjelltas.

7. Kompania e agjentëve, nuk ka të drejtë t'i ngarkojë me tarifë apo provizion të siguruarin.

8. Kompania e brokerimit nuk mund të pranojë komisione apo pagesa tjera nga i siguruari, përveç nëse janë pajtuar ndryshe, me marrëveshje të shkruar me të siguruarin.

9. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të këtij neni.

Neni 121

Mbikëqyrja e ndërmjetësuesve, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve tjerë të sigurimeve

1. BQK-ja do të bëjë mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve

tjerë.

2. Mbikëqyrja e subjekteve nga paragrafi 1 i këtij neni, së paku do të përfshij:

- 2.1. mbledhjen dhe verifikimin e informatave të dërguara dhe të kërkuara nga BQK-ja;
- 2.2. mbikëqyrja e transaksioneve biznesore të subjekteve nga paragrafi 1 i këtij neni me siguruesin dhe të sigruarin;
- 2.3. mbikëqyrjen e adekuatshmërisë së kapitalit të subjekteve nga paragrafi 1 i këtij neni dhe ndikimin e tij në të sigruarin dhe siguruesin;
- 2.4. të konfirmojë se subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, rregulloreve në zbatim të tij dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- 2.5. të konfirmojë se subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni veprojnë në pajtim me kodin e etikës dhe rregullat në fushën e sigurimeve;
- 2.6. të konfirmojë se subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni i përmbushin urdhrat e BQK-së brenda afateve të përshkruara me urdhrat përkatës.

3. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e siguruesve, aplikohen përshtatshëmrisht edhe për mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve në sigurime, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve tjerë.

Neni 122

Informatat e nevojshme për mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve tjerë të sigurimeve

1. Për qëllime të mbikëqyrjes, sipas nenit 120 të këtij ligji, BQK-ja mund të:

- 1.1. kërkojë raporte nga ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë të sigurimeve;
- 1.2. bëjë ekzaminime në vend, me qëllim që të verifikojë vërtetësinë e informatave të raporteve që janë sjell në BQK me shpenzimet e kompanisë.

2. Ndërmjetësuesit duhet të përgatisin raporte tre (3) mujore për primet e shitura.

3. Ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë duhet të përgatitin dhe sjellin në BQK raportet financiare për çdo tre (3) muaj. Këto raporte duhet të përgatiten në pajtim me kërkesat e BQK-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Raportet financiare tre (3) mujore duhet të dorëzohen në BQK brenda tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i tremujorit për të cilin janë përgatitur.

4. Ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë, duhet të dorëzojnë në BQK, pasqyrat financiare të audituara nga një auditor i jashtëm për vitin paraprak, jo më vonë se data 30 prill e vitit vijues.

5. BQK-ja mund të përjashtojë ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë nga përgatitja dhe paraqitja e disa raporteve nëse BQK-ja i konsideron të panevojshme.
6. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të dispozitave të këtij neni.

Neni 123

Regjistri i ndërmjetësuesve, trajtuesve të dëmeve dhe profesionistëve tjerë në sigurime

1. BQK-ja do të mbajë regjistër që e publikon në faqen e saj të internetit, ku përfshihen të gjithë ndërmjetësuesit, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë, të licencuar nga BQK-ja.
2. Regjistri nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbajë informata të përgjithshme për personat dhe kompanitë e licencuara.
3. BQK-ja mund të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga ky nen.

KAPITULLI XX

MASAT ADMINISTRATIVE, DËNIMET ME GJOBË, PEZULLIMI APO LARGIMI I PERSONAVE DHE SHQYRTIMET GJYQËSORE

Neni 124

Masat administrative

1. BQK-ja mund të shqiptojë, proporcionalisht me shkeljet, masa administrative ndaj një siguruesi, ndërmjetësuesve të sigurimeve, dhe subjekteve tjera, mbi të cilat ka autoritet t'i licencojë, rregullojë dhe mbikëqyrë, nëse konstaton se siguruesi, këto subjekte, cilido nga aksionarët e rëndësishëm, drejtorët, menaxhmenti i lartë apo punonjësit e tyre, kanë shkelur ndonjë dispozitë të këtij ligji apo ndonjë rregullore ose urdhër të lëshuar nga BQK-ja.
2. Për shkeljet siç u përmendën nga paragrafi 1 i këtij neni, BQK-ja mund të shqiptojë një apo më shumë nga masat në vijim:
 - 2.1. jep vërejtje me shkrim;
 - 2.2. kërkon rritjen e frekuencës së raportimit;
 - 2.3. ndalon lëshimin e policave të reja të sigurimit apo ndalon përtëritjen e policave ekzistuese;
 - 2.4. cakton kufizime në aktivitet;
 - 2.5. urdhëron siguruesit apo subjektet tjera të këtij neni të ndërpresin kryerjen e veprimeve të caktuara;
 - 2.6. urdhëron bordin e drejtorëve të thërrasin mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve dhe t'i propozojë marrjen e vendimeve përkatëse;

- 2.7. shqipton dënime me gjobë në pajtim me nenin 125 të këtij ligji;
- 2.8. urdhëron siguruesit apo subjektet tjera të këtij neni, që të ndërmarrin masa shtesë, në mënyrë që t'i ruajë pasuritë e tyre;
- 2.9. urdhëron siguruesit apo subjektet tjera të këtij neni, që të rrisin kapitalin themelues;
- 2.10. kërkon nga siguruesi apo subjekti tjetër i këtij neni, të paraqesë planin e rimëkëmbjes financiare, sipas kërkesave të nenit 63 të këtij ligji;
- 2.11 emëron këshilltar për siguruesin.
3. Kërkon nga auditori i jashtëm i siguruesit apo subjektit tjetër të këtij neni të raportojë drejtpërdrejtë në BQK:
- 3.1.cakton një firmë të auditimit të jashtëm për siguruesin apo subjektin tjetër të këtij neni, me shpenzimet e tyre dhe kjo firmë e auditimit do t'i raportojë drejtpërdrejt BQK-së;
- 3.2. cakton një aktuar për siguruesin, me shpenzime të siguruesit dhe ky aktuar do t'i raportojë drejtpërdrejt BQK-së;
- 3.3. vendos siguruesit nën administrim të përkohshëm me qëllim të kthimit në situatë financiare të mirë dhe emëron administratorin ligjor për këtë qëllim;
- 3.4. administron dhe merr nën kontroll pasurinë e siguruesit;
- 3.5. pezullon licencën e siguruesit apo subjektit tjetër të këtij neni;
- 3.6. anulon (revokon) licencën e siguruesit apo subjektit tjetër të këtij neni.
4. Për qëllime të këtij neni, subjekte tjera konsiderohen: ndërmjetësuesit e sigurimeve, trajtuesit e dëmeve dhe profesionistët tjerë të sigurimeve.
5. BQK-ja mund t'i publikojë në faqen e saj të internetit masat administrative të shqiptuara sipas këtij neni.

Neni 125

Dënimet me gjobë

1. Nëse BQK-ja konstaton se një sigurues, ndërmjetësues i sigurimeve, subjekt tjetër mbi të cilin ka autoritet ta licencojë, rregullojë dhe mbikëqyrë; drejtor, menaxher i lartë apo punonjës i tyre ka shkelur këtë ligj, rregulloret apo urdhrat në zbatim të tij, BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë.
2. BQK-ja mund të shqiptojë dënim me gjobë edhe ndaj administratorit të përkohshëm të emëruar nga ajo vet dhe ndaj çdo personi tjetër që pengon dhe vështirëson mbikëqyrjen nga ana e BQK-së.
3. BQK-ja mund të shqiptojë dënime me gjobë ndaj çdo personi, i cili me qëllim pengon administratorin e përkohshëm, të emëruar nga BQK-ja të marrë nën kontroll zyret, librat e

kontabilitetit, të dhënat dhe pasuritë tjera të siguruesit, nën administrim ligjor.

4. BQK-ja nxjerrë rregullore të veçantë që përcaktojnë shkeljet dhe dënimet me gjobë për këto shkelje. Nëse ekziston shkelje e vazhdueshme, secila ditë e shkeljes konsiderohet shkelje e veçantë, për të cilat mund të caktohen ndëshkime të veçanta.

5. Dënimet me gjobë, të shqiptuara sipas këtij neni, nuk prejudikojnë dhe nuk pengojnë zbatimin e mjeteve tjera juridike dhe ndëshkimeve penale të parapara me legjislacionin në fuqi.

6. Personi ndaj të cilit është caktuar dënimi me gjobë, sipas këtij ligji, ka të drejtë ta ankimojë atë dënim brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit.

7. Dënimet me gjobë të shqiptuara sipas këtij neni paguhet në llogari të Buxhetit të Kosovës.

Neni 126

Pezullimi dhe largimi i personave në një sigurues, ndërmjetësues të sigurimeve dhe trajtues të dëmeve dhe profesionistëve tjerë

1. Nëse BQK-ja konstaton se ndonjë aksionar, drejtor, menaxher i lartë apo punonjës i një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve ose trajtuesi të dëmeve, ka bërë shkelje të këtij ligji, rregulloreve apo urdhrave të BQK-së apo është angazhuar në praktika të pasigurta dhe ka vazhduar me shkelje ose praktika të tilla edhe pas vërejtjes së BQK-së, BQK-ja mund të urdhërojë një apo më shumë nga masat në vijim:

1.1. i kërkon siguruesit, ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve në sigurime të shkarkojë personin e caktuar nga posti i tij;

1.2. i ndalon këtij personi shërbimin apo pjesëmarrjen në punët e sigurimeve për një afat të caktuar apo përgjithmonë;

1.3. ia ndalon personit ushtrimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të së drejtës së votimit, që lidhet me siguruesin, ndërmjetësuesin apo trajtuesin e dëmeve;

1.4. kërkon prej personit që të heqë dorë nga tërë pjesa apo një pjesë e interesit pronësor të tij të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në siguruesin, ndërmjetësuesin apo trajtuesin e dëmeve apo të ndërpresë mbajtjen e një interesi të rëndësishëm në të; dhe

1.5. kërkon prej personit që t'ia kompensojë siguruesit, ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve, dëmet që mund të jenë shkaktuar nga këto shkelje.

2. Nëse ndonjëri prej këtyre personave është i akuzuar me ndonjë vepër penale, BQK-ja mund të lëshojë urdhrin për suspendimin e përkohshëm të këtij personi nga posti i tij/saj në siguruesin, ndërmjetësuesin apo trajtuesin e dëmeve dhe, nëse është e aplikueshme, suspendimin e ushtrimit të së drejtës së votimit që rrjedh nga aksionet nga ky person, deri në zgjidhjen e lëndës penale. Pezullimi i lëndës penale apo vendimi për pafajësi nuk e pengon BQK-në që të marrë ndonjë masë ligjore sa i përket këtij personi sipas këtij ligji.

3. Në rast se ndonjë person nuk i shet ose heq dorë prej aksioneve me të drejtë vote të siguruesit, ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve në përputhje me urdhrin e lëshuar sipas këtij neni brenda periudhës kohore të përcaktuar, BQK-ja urdhëron që të gjitha aksionet që mbahen nga ky person, t'i kalohen një administratori të besuar për t'i shitur në ankand dhe të hyrat neto, pa

shpenzimet e shitjes, do t'i kthehen atij personi.

Neni 127

Shqyrtimet gjyqësore

1. Personat e dënuar me gjobë apo që konsiderojnë se janë dëmtuar nga një masë administrative, gjobë apo urdhër tjetër të lëshuar nga BQK-ja sipas këtij ligji, kanë të drejtë të kërkojnë nga Gjykata kompetente që ta shqyrtojë atë brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit ose urdhrit. Gjykata ka autorizim që ta konfirmojë, ndryshojë apo anulojë në tërësi këtë vendim apo urdhër.

2. Në çdo procedurë gjyqësore të një Gjykate që ka juridiksion për ta rishikuar një urdhër apo dënim të lëshuar nga BQK-ja, kjo Gjykatë mund refuzojë një urdhër ose dënim, nëse konstaton se është lëshuar në kundërshtim me këtë ligj ose në kundërshtim me Ligjin në fuqi dhe se ai urdhër ose dënim me gjobë nuk është mbështetur në dëshmi të qëndrueshme.

3. Urdhri apo dënimi me gjobë i lëshuar nga BQK-ja, që ka të bëjë me një proces të tillë gjyqësor vazhdon pa kurrfarë kufizimi gjatë procedurës gjyqësore dhe përderisa ekzekutimi i tyre nuk është pezulluar me vendim gjyqësor.

KAPITULLI XXI

DISPOZITA TË TJERA

Neni 128

Memorandumet e mirëkuptimit

Gjatë zbatimit të këtij ligji, BQK-ja mund të lidhë memorandume të mirëkuptimit ose marrëveshje tjera bashkëpunimi me institucionet tjera shtetërore të Kosovës, me autoritete mbikëqyrëse të shteteve tjera, si dhe me institucione ndërkombëtare, me qëllimin për të lehtësuar funksionet licencuese, mbikëqyrëse dhe rregulluese sipas këtij ligji, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në shkëmbimin e informatave, trajnimin, koordinimin e inspektimeve dhe hetimeve.

Neni 129

Parandalimi i pastrimit të parave

1. Asnjë siguries nuk duhet të fshehë, të konvertojë apo transferojë në para apo pronë tjetër, në qoftë se ka njohuri ose duhet të ketë qenë në dijeni që këto para ose pasuri tjetër, burojnë nga aktiviteti kriminal ose të ndihmojë apo mbështesë ndonjë person në fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të parave të gatshme apo pasurisë.

2. Siguruesit duhet t'i përmbahen Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. BQK-ja dhe Njësia e Inteligjencës Financiare do të bashkëpunojnë në pajtim me ligjet e aplikueshme.

3. Siguruesit do t'u përmbahen të gjitha ligjeve, rregulloreve, rregullave, udhëzimeve, procedurave dhe urdhrave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 130**Tarifat e licencimit dhe mbikëqyrjes**

1. Siguruesit/risiguruesit, ndërmjetësuesit dhe subjektet tjera të këtij ligji, paguajnë në BQK, tarifën e licencimit, miratimit apo autorizimit.
2. Përveç tarifës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, siguruesit, ndërmjetësuesit dhe subjektet tjera të këtij ligji, që veprojnë në Republikën e Kosovës, paguajnë në BQK edhe tarifën e mbikëqyrjes.
3. Nëse licencimi, miratimi apo autorizimi refuzohet nga BQK-ja, tarifa e paguara nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kthehet.
4. BQK-ja me rregullore, përcakton shumën dhe frekuencën e tarifave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni.

KAPITULLI XXII**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE****Neni 131****Përshtatja e sigurueseve**

1. Siguruesit të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë licencë për të ushtruar një veprimtari sigurimi, vazhdon të ushtrojë veprimtari sigurimi sipas dispozitave të këtij ligji në klasat e sigurimit të përcaktuara në licencën ekzistuese.
2. Brenda një periudhe një (1) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, siguruesit e licencuar janë të detyruar ta përshtatin veprimtarinë e tyre, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji. Brenda afatit të përcaktuar me këtë paragraf, siguruesi është e detyruar të përshtatë:
 - 2.1. kapitalin në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;
 - 2.2. organet e siguruesit në pajtim me nenin 25 të këtij ligji;
 - 2.3. anëtarët e bordit të drejtorëve në pajtim me nenet 27, 28 dhe 29 të këtij ligji;
 - 2.4. komitetin e auditimit dhe komitetin e menaxhimit të rrezikut në pajtim me nenin 30 të këtij ligji;
 - 2.5. të krijojë funksionet e kontrollit dhe auditimit të brendshëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
3. Siguruesi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, brenda një (1) muaji nga përfundimi i periudhës kohore të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të dorëzojnë në BQK një raport mbi përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.
4. BQK-ja mund të revokojë licencën e siguruesit dhe të hapë procedurat e likuidimit, në

përputhje me dispozitat e këtij ligji, nëse siguruesit e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, brenda afatit të përcaktuar, nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 132

Përshtatja e ndërmjetësuesve dhe trajtuesve të dëmeve

1. Ndërmjetësuesit dhe trajtuesit e dëmeve, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë licencë për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime apo trajtimin të dëmeve, duhet ta përshtatin veprimtarinë e tyre me dispozitat e këtij ligji brenda një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Subjektet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, janë të detyruara që brenda një (1) muaji nga data e përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni të dorëzojnë në BQK, një raport për përshtatjen e veprimtarisë në përputhje me këtë ligj, si dhe dokumentacionin shoqërues përkatës.
3. Nëse subjektet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 sipas këtij neni, BQK-ja mund të revokojë licencat në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 133

Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/25 mbi licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve.
2. Aktet nënligjore të nxjerra nga BQK-ja mbi licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në miratimin e akteve të reja nënligjore nga BQK-ja mbesin në fuqi.
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, BQK-ja nxjerr aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji.

Neni 134

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -045
30 nëntor 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-035-2015, datë 16.12.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.